


VLERËSIMI I QEVERISJES SË MIRË NË NË NJËSITË E VETËQEVERISJES LOKALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT PËRMES INDEKSIT TË HAPJES

MATJA PËR VITIN 2024



© 2024 Fondacioni për Internet dhe Shoqëri - “Metamorfozis”

Shkup, 2024

Titulli i originalit: “Процена на доброто владеење во единиците на локалната самоуправа во Република Северна Македонија преку Индексот на отвореност мерење за 2024 година”

Botues: Fondacioni për Internet dhe Shoqëri - Metamorfozis
Rr. “Franklin Ruzvelt” nr. 19, kati 2, 1000 Shkup, Maqedonia e Veriut

Autore: Milla Josifovska Danillovska

Redaktore: Dançe Danillovska Bajdevska

Dizajni: Fondacioni për Internet dhe Shoqëri - “Metamorfozis” (Maqedonia e Veriut)

Përktimi nga maqedonishtja në shqip: Valon Abdiu

Lektura: BESTEL DOOEL SKOPJE (Maqedonia e Veriut)

kopje elektronike

SHËNIMI CIP: CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека “Св. Климент Охридски”, Скопје

352.077:005.332.5(497.7)“2024”(047.31)

JOSIFOVSKA Danillovska, Milla
Vlerësimi i qeverisjes së mirë në njësitë e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes Indeksit të hapjes : matja për vitin 2024 / [autore Milla Josifovska Danillovska ; përktimi nga maqedonishtja në shqip Valon Abdiu]. - Скопје : Фондација за интернет и општество Метаморфозис, 2024

Начин на пристапување (URL):
<https://metamorphosis.org.mk/wp-content/uploads/2024/10/vleresimi-i-qeverisjes-se-mire-ne-njesite-e-veteqeverisjes-lokale-ne-republiken-e-maqedonise-se-veriut-permes-indeksit-te-hapjes-final.pdf>.

- Превод на делото: Процена на доброто владеење во единиците на локалната самоуправа во Република Северна Македонија преку Индексот на отвореност : мерење за 2024 година. - Текст во PDF формат, содржи 43 стр., илустр. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 07.10.2024. - Фусноти кон текстот. - Содржи и: Shtojca

ISBN 978-608-263-125-7

a) Локална самоуправа -- Добро владеење -- Индекс на отвореност -- Македонија -- 2024 -- Истражувања

COBISS.MK-ID 64509445

Publikimi është bërë i mundur me mbështetjen e Qeverisë së Zvicrës përmes “Civica Mobilitas” në kuadër të projektit “Transformimi digjital në nivel lokal - Komuniteti i përfshirë për rezistencë ndaj korrupsionit (DIGILOC)” i zbatuar nga Fondacioni për Internet dhe Shoqëri “Metamorfozis” në partneritet me Koalicionin Rural dhe Qendrën për Inovacione Sociale “Blink 42-21”.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Fondacionit për Internet dhe Shoqëri “Metamorfozis” dhe Koalicionit Rural dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i pasqyron pikëpamjet e qeverisë zvicerane, “Civica Mobilitas”-it ose organizatave që e zbatojnë.

Përmbajtja

Hyrje.....	4
Metodologjia.....	5
1. Hapja e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut	7
1.1 Gjendja e qeverisjes së mirë në vetëqeverisjen lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut.....	7
1.2 TRANSPARENCA	13
1.2.1. Angazhimi për transparencë dhe llogaridhënie.....	16
1.2.2. Informacioni për organizatën	17
1.2.3. Marrja e vendimeve	18
1.2.4. Transparenca financiare.....	19
1.3 VETËDIJËSIMI	21
1.3.1. Planifikimi dhe programimi.....	22
1.3.2. Monitorimi dhe vlerësimi.....	22
1.4 QASSHMËRIA.....	23
1.4.1. Qasja në informata dhe shërbime	24
1.4.2. Konsultimet publike	26
1.4.3. Ndërveprimi me qytetarët	27
1.5 INTEGRITETI.....	28
1.5.1. Politikat për integritet dhe konflikt të interesit	29
1.6 TË DHËNAT E HAPURA	30
2. Plani gjithëpërfshirës për qeverisje të mirë në institucionet e pushtetit lokal në Republikën e Maqedonisë së Veriut	33
Shtojca 1. Struktura e Indeksit të Hapjes në nivel lokal.....	38

Hyrje

Qeverisja e mirë në nivel lokal është e një rëndësie vendimtare sepse ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së qytetarëve përmes menaxhimit efektiv dhe transparent. Koncepti i qeverisjes së mirë përfshin një spektër më të gjerë politikash dhe praktikash që çojnë në mënyra të reja të qeverisjes, duke promovuar qeverisjen e hapur dhe duke inkurajuar vendimmarrje më të mirë, reduktim të korrupsionit dhe shërbime publike më efikase.

Transparenca, si karakteristikë kryesore, siguron disponueshmërinë e informatave dhe të dhënave të nevojshme për kontrollin e autoriteteve lokale, gjë që e rrit besimin e qytetarëve në njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe i inkurajon ata të marrin pjesë aktive në proceset vendimmarrëse. Përveç transparencës, qeverisja e mirë bazohet në parimet e pjesëmarrjes, përgjegjësisë dhe integritetit, duke krijuar komunitete më gjithëpërfshirëse dhe të përgjegjshme, gjë që është me rëndësi thelbësore për zhvillimin e qëndrueshëm dhe prosperitetin e shoqërisë.

Për të matur deri në çfarë mase njësitë e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut i respektojnë këto parime, Fondacioni për Internet dhe Shoqëri "Metamorfozis" në partneritet me Koalicionin Rural, e me mbështetjen e qeverisë zvicerane përmes programit "Civica Mobilitas", përgatiti vlerësim të gjendjes së qeverisjes së mirë të njësive të vetëqeverisjes lokale (NJVL) në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2024.

Vlerësimi është rezultat i hulumtimit të realizuar bazuar në Indeksin e Hapjes, i cili ka për qëllim të përcaktojë shkallën në të cilën respektohen parimet e qeverisjes së mirë, në këtë rast nga pushteti lokal në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Indeksi i Hapjes bazohet në metodologjinë e Indeksit të Hapjes së NJVL-ve në rajonin e Ballkanit Perëndimor të cilin e zbaton ACTION SEE - rrjeti për përgjegjësi, teknologji dhe Hapje të institucioneve në Evropën Juglindore. Indeksi i merr parasysh dallimet dhe specifikat e secilit prej vendeve, si për sa u përket detyrimeve ligjore për NJVL-të, ashtu edhe për sa u përket praktikave. Metodologjia u rishikua në fillim të vitit 2021 dhe në fillim të vitit 2024 për t'i përshtatur komponentët e Indeksit (fushat, nënfushat, treguesit, mjetet) për të mundësuar zbatueshmërinë e tij të plotë dhe rëndësinë për vlerësimin e hapjes së NJVL-ve në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Ky raport ofron një analizë të punës së NJVL-ve në Republikën e Maqedonisë së Veriut për sa u përket parimeve të transparencës, vetëdijësimit, qasshmërisë dhe integritetit, me një domen të përbashkët të pranishëm në të katër parimet - të dhënat e hapura. Në bazë të vlerësimit të realizuar, janë dhënë rekomandime për përmirësimin e funksionimit të NJVL-ve në fushat që janë të përfshira në hulumtim.

Qëllimi i aktiviteteve tona është të kontribuojmë në zbatimin e reformave në këtë fushë, duke ndërtuar një marrëdhënie partneriteti me vetëqeverisjen lokale. Me rekomandimet tona përpiqemi t'u ndihmojmë NJVL-ve të bëhen më të hapura dhe të përgjegjshme, gjë që do të përmirësojë cilësinë e jetës së qytetarëve dhe do të forcojë rolin e tyre në proceset vendimmarrëse sipas nevojave të tyre.

Metodologjia

Indeksi i Hapjes e vlerëson performancën e vetëqeverisjes lokale në fushën e qeverisjes së mirë duke u fokusuar në katër parime: (1) transparencë, (2) vetëdijësimi, (3) qasshmëria dhe (4) integriteti dhe një domen i përbashkët që është i pranishëm në të katër parimet - të dhënat e hapura.

Indeksi i hapjes është një mjet praktik për matjen e hapjes së përgjithshme të NJVL-ve, që:

- jep pasqyrë të hollësishme të të gjitha aspekteve që lidhen me hapjen e çdo NJVL-je;
- mundëson krahasueshmërinë ndërmjet NJVL-ve për të inkurajuar mësimin e ndërsjellë dhe shkëmbimin e praktikave më të mira;
- krijon motivim midis NJVL-ve për përmirësim dhe inovacion të vazhdueshëm;
- është i arritshëm dhe i kuptueshëm për qytetarët që të kenë një pasqyrë mbi hapjen e NJVL-ve të tyre, si një nga kriteret kryesore për vlerësimin e performancës dhe suksesit.

Treguesit janë të organizuar në katër fusha dhe nëntë nënfusha. Katër fushat korrespondojnë me katër parimet e qeverisjes së hapur: transparencë, vetëdijësimi, qasshmëria dhe integriteti. Përveç kësaj, indeksi përmban edhe dy nënkategori – këshillat komunalë dhe ndërmarrjet publike, gjë që mundëson vlerësimin e hapjes së NJVL-ve kur bëhet fjalë konkretisht për punën e këshillave apo ndërmarrjeve publike.

Fusha e **transparencës** u referohet politikave, aktiviteteve dhe masave të cilat NJVL-ja i ndërmerr për të informuar qytetarët për punën e saj. Nisur nga qëndrimi se transparencë është baza e hapjes së NJVL-ve, kjo fushë e Indeksit përmban më së shumti tregues, duke përfshirë edhe transparencën financiare si një nga aspektet më të rëndësishme të punës së NJVL-së.

Fusha e **vetëdijësimit** i referohet cilësisë së planifikimit, programimit, monitorimit dhe vlerësimit të politikave që zbatohen nga ana e autoriteteve lokale. Kjo e nënkupton parashikueshmërinë e zbatimit të interesit publik nëpërmjet politikave publike në NJVL. Kjo fushë e shqyrton procesin e krijimit të politikave publike në NJVL, përgatitjen dhe miratimin e dokumenteve strategjike, planeve të veprimit, si dhe zhvillimin e një plani dhe mjeteve për monitorim dhe vlerësim gjatë zbatimit të kompetencave sektoriale që i ka NJVL-ja.

Fusha e **qasshmërisë** i referohet mënyrës se si NJVL-ja komunikon dhe i përfshin qytetarët e NJVL-së kur përgjigjet ndaj kërkesave të tyre dhe kur i plotëson nevojat e tyre. Qasshmëria lidhet me sigurimin dhe respektimin e procedurave për qasje të lirë në informata, përmirësimin e qasshmërisë së informatave përmes mekanizmave për debat publik dhe forcimin e ndërveprimit me qytetarët dhe pjesëmarrjen e tyre.

Fusha e **integritetit** shqyrtohet në funksion të respektimit të vazhdueshëm të vlerave, parimeve dhe normave etike që synojnë prioritizimin e interesit publik ndaj atij privat.

Të dhënat e hapura janë një aspekt i rëndësishëm i këtij Indeksi dhe shqyrtohen si fushë horizontale. Sipas Strategjisë për të dhënat e hapura, të dhënat e hapura njihen si një mundësi për të përmirësuar qeverisjen në aspektin e transparencës dhe llogaridhënies në të gjitha nivelet, duke përfshirë edhe atë lokal, e gjithashtu mund të jenë një nxitje e fortë për zhvillimin ekonomik dhe social të vendit. Në kuadër të Indeksit, për disa nga treguesit, analizohet më tej mënyra e

publikimit të të dhënave dhe formati i tyre në prizmin e hapjes së të dhënave. Nëpërmjet kësaj qasjeje horizontale, përpiqemi të vlerësojmë angazhimin e NJVL-së për përmbushjen e kërkesave për të dhëna të hapura.

Përpunimi dhe revizioni i Metodologjisë u krye mbi bazën e një analize të detajuar të kornizës kombëtare strategjike dhe ligjore të RMV-së, dokumenteve ndërkombëtare, iniciativave, standardeve, rekomandimeve dhe praktikave të mira, hulumtimeve mbi perceptimet dhe pritjet e qytetarëve të RMV-së, si dhe intervistave me palët e interesuara përkatëse.

Hulumtimi u krye nga ana e Fondacionit për Internet dhe Shoqëri "Metamorfozis", në partneritet me Koalicionin Rural.

Me hulumtimin për vitin 2024 u përfshinë të gjitha NJVL-të, gjegjësisht 80 komuna dhe qyteti i Shkupit. Hulumtimi është kryer nga 1 shkurt deri më 15 maj 2024. Metodatat e hulumtimit ishin nëpërmjet (1) inspektimit të faqeve të internetit të NJVL-së sipas treguesve të përcaktuar dhe (2) një pyetësori që iu dorëzua NJVL-së për të konfirmuar konstatimet e fituara nga monitorimi online. Si burim bazë për mbledhjen e informacionit, metodologjia i merr faqet zyrtare të internetit të NJVL-së. Niveli i dytë i kontrollit për disa nga treguesit nënkuptonte procesin e përgatitjes dhe realizimit të një pyetësori si mjet hulumtues. Pyetësori u realizua në mënyrë elektronike dhe përbëhej nga pyetje të paracaktuara dhe opsione përgjigjesh, të cilat mundësojnë konfirmimin ose plotësimin e disa prej konstatimeve të fituara nga monitorimi i faqeve të internetit, si dhe eliminimin e lëshimeve të mundshme gjatë monitorimit që do të ishin të dëmshme për vlerësimin e NJVL-së për një tregues specifik.

Gabimi në matjen është $\pm 3\%$. Bazuar në rezultatet e hulumtimit, kemi bërë një analizë me pikat dhe problemet kyçe kritike në fushën e hapjes së NJVL-ve, të cilat shpresojmë se do të përdoren për përmirësimin e punës së tyre.


Nga 80 komunat e monitoruara dhe Qyteti i Shkupit, **pyetësorit iu përgjigjën 42 NJVL (51,85%)**, që krahasuar me monitorimin e fundit nga viti 2022.¹ paraqet **rritje për gjashtë NJVL (7,4%)**. Është e rëndësishme të theksohet se në rastet kur NJVL-të nuk kanë dorëzuar përgjigje të pyetësorit, për treguesit është dhënë nota 0, gjegjësisht është vlerësuar sikur treguesit nuk janë plotësuar. Në fakt, nga NJVL-të e monitoruara, 39 NJVL-të e mbetura (48,15%) që nuk iu përgjigjën pyetësorit marrin automatikisht 0 për treguesit përkatës ku burimi i informacionit është vetëm përgjigja e NJVL-së.

Gjithashtu, të gjitha NJVL-ve u janë dërguar kërkesa për qasje falas në informatat me karakter publik, sipas të cilave u vlerësua përgjegjshmëria e tyre në përputhje me Ligjin për qasje të lirë në informatat me karakter publik. Nga 81 NJVL, gjithsej **63 NJVL (77,77%) iu përgjigjën kërkesës brenda afatit ligjor**.

Në Shtojcën 1 mund ta shihni strukturën e përgjithshme të Indeksit të Hapjes në nivel lokal.

¹ Indeksi i Hapjes së vetëqeverisjes lokale për vitin 2022. Fondacioni Metamorfozis. Gjendet në: https://metamorphosis.org.mk/izdanija_arhiva/index-na-otvorenost-na-lokalnata-samouprava-za-2022-godina/

1. HAPJA E VETËQEVERISJES LOKALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT



1. Hapja e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut

1.1 Gjendja e qeverisjes së mirë në vetëqeverisjen lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Vetëqeverisja lokale luan rol kryesor në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve duke ofruar shërbime bazë siç është arsimi dhe infrastruktura, duke vepruar si një urë lidhëse midis komunitetit dhe niveleve më të larta të pushtetit dhe duke siguruar që nevojat lokale të adresohen në mënyrë adekuate.


Zgjedhjet e fundit lokale në tetor të viti 2021 sollën ndryshime në udhëheqësinë e shumë NJVL-ve, ndërsa zgjedhjet e ardhshme lokale pritet të mbahen në tetor të vitit 2025. Pasojat e krizës shëndetësore, por edhe asaj globale energjetike-ekonomike vazhdojnë të mbeten si sfida që ndikojnë në funksionalitetin e sektorit publik, duke përfshirë edhe NJVL-të. Në kushte të tilla të krizës ekonomike, qytetarët po bëhen gjithnjë e më të ndjeshëm ndaj transparencës dhe llogaridhënies së autoriteteve lokale, para së gjithash, për punën e tyre financiare dhe për efektet e punës nëpërmjet cilësisë dhe çmimeve të shërbimeve.

Me rritjen e nevojave të qytetarëve për qasje më të shpejtë dhe më të lehtë në informata dhe shërbime, kërkesat ndaj vetëqeverisjes lokale rriten në mënyrë të pashmangshme. Kjo dinamikë e pasqyron pritshmërinë në rritje nga autoritetet lokale jo vetëm për t'i zgjidhur problemet imediate, por edhe për t'i parashikuar dhe për t'u përshtatur me sfidat e reja. Pavarësisht se a bëhet fjalë për zhvillimin e infrastrukturës, shërbimet sociale apo mjedisin jetësor, NJVL-ve u kërkohet gjithnjë e më shumë të ofrojnë zgjidhje inovative që i plotësojnë standardet më të larta të vendosura nga komunitetet e tyre. Ky përshkallëzim i kërkesës e nënvizon rolin kritik të pushtetit lokal në nxitjen e komuniteteve rezistente, të përgjegjshme dhe të përparuara.

Hulumtimi për vitin 2024 krahasuar me vitin 2022 ka treguar një hapje të shtuar të vetëqeverisjes lokale, megjithëse ka ende shumë vend për përmirësim. Krahasuar me vitin 2022 kur vetëqeverisja lokale përmbushi mesatarisht 27% të treguesve të hapjes, **në vitin 2024, mesatarja e hapjes arriti në 37%, gjë që është një rritje prej 10% për dy vjet.** Edhe pse kjo përqindje është rritur dukshëm, megjithatë ajo është një tregues i **nivelit të ulët të hapjes në funksionimin e pushtetit lokal në Republikën e Maqedonisë së Veriut**, përveç rasteve të veçanta që në mënyrë proaktive dhe të plotë i përkushtohen hapjes ndaj qytetarëve.

Ashtu si në vitin 2022, edhe në vitin 2024 NJVL-të kanë vlerësimin mesatar më të lartë në fushën e **transparencës (46%)**, ndërsa vlerësim mesatarë më të ulët në fushën e **vetëdijësimit (21%)**, ndërsa progresi më i madh vihet re në fushën e **transparencës** dhe **integritetit** gjegjësisht një rritje prej 12%.

Hapja e NJVL-ve për vitin 2024 sipas parimeve të Indeksit të hapjes



Infografiku 1. Hapja e NJVL-ve për vitin 2024 sipas parimeve të Indeksit të Hapjes

Sërish, ky rezultat i ulët në fushën e vetëdijësimit (21%) tregon për cilësinë e dobët të planifikimit, programimit, monitorimit dhe vlerësimit të politikave të zbatuara nga NJVL-të. Interesi publik duhet të reflektohet në politikat publike, gjë që e bën këtë rezultat të dobët edhe më alarmues.

Ligji për organizimin territorial të Vetëqeverisjes Lokale² e organizon vetëqeverisjen lokale territorialisht në 80 komuna dhe në Qytetin e Shkupit si NJVL e veçantë, ndërsa para Kushtetutës³ NJVL-të janë të barabarta në të drejtat dhe detyrat e tyre, pavarësisht nga karakteri i tyre urban apo rural, shkalla e zhvillimit, madhësia hapësinore dhe demografike dhe dallimet e specifikat e tjera. Kështu, në hulumtim të gjitha NJVL-të trajtohen në mënyrë të barabartë, pavarësisht nga madhësia e tyre, numri i punonjësve etj. Parimet e transparencës të përfshira në Indeksin e Hapjes mbulohen në një sërë ligjesh, aktesh nënligjore dhe doracakësh me qëllim të përmirësimit të hapjes së institucioneve të pushtetit lokal dhe të përmirësimit të cilësisë së jetës së qytetarëve.


Në vitin 2024, konstatimet nga Indeksi i Hapjes treguan se **NJVL-të më të hapura janë Manastiri (67%), Dellçeva (66%), Demir Hisari (64%), Velesi (60%), Vallandova (59%), Prilepi (58%), Kriva Pallanka (58%), Berova (58%), Vasileva (56%), Koçana (55%), Gradskoja (54%), Gjevgjelia (54%), Ohri (53%), Kavadari (52%) dhe Gazi Baba (52%), kundrejt NJVL-ve më të mbyllura ku bëjnë pjesë Sopishteja (7%), Krivogashtani (13%), Studeniçani (13%), Rosomani (14%), Çußer Sandeva (15%), Shuto Orizari (16%), Llozova (17%), Bogovina (18%), Rankovca (18%), Vrapçishti (19%) dhe Çairi**

² Ligji për organizimin territorial të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë. Ministria e Vetëqeverisjes Lokale. Gjendet në: <https://tinyurl.com/57axafnj>

³ Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Gjendet në: <https://www.sobranie.mk/ustav-na-rm.nspj>


(19%). Në raport me vitin 2022 ka ndryshime në renditje, gjegjësisht në vend të Vallandovës, komuna më e hapur është **Manastiri**.

NJVL-të më të hapura sipas Indeksit të Hapjes për vitin 2024




Infografiku 2. NJVL-të më të hapura sipas Indeksit të Hapjes për vitin 2024

NJVL-të më të mbyllura sipas Indeksit të Hapjes për vitin 2024



Infografiku 3. NJVL-të më të mbyllura sipas Indeksit të Hapjes për vitin 2024

Për sa u përket rajoneve të planit, konstatimet e këtij viti tregojnë se **NJVL-të në Rajonin Lindor janë më të hapurat (43.4%)**, për dallim nga viti 2022, kur më të hapura ishin NJVL-të e Rajonit Juglindor, ndërsa **më të mbyllurat edhe këtë vit janë NJVL-të nga Rajoni i Shkupit (29,2%)**. Edhe pse krahasuar me hulumtimin e vitit 2022 ka pasur përparim në të gjitha rajonet e planit, **progresi më i madh prej 14% vihet re në Rajonin Lindor**, ndërsa **përparimin më të vogël e kanë Rajoni Juglindor, i Pellagonisë dhe ai Jugperëndimor prej 7%.**



Infografiku 4. Hapja e vetëqeverisjes lokale sipas rajoneve planifikuese në vitin 2024

Nga 81 NJVL-të e monitoruara, përmbushje prej **mbi 50% të treguesve të Indeksit të Hapjes kanë 33 NJVL**, nga të cilat 13 NJVL-të më të mëdha dhe 20 më të vogla me më pak se 30,000 banorë sipas Regjistrimit të fundit të popullsisë⁴, që krahasuar me vitin 2022 është **një rritje prej 25 NJVL**.

Përmbushje të treguesve të Indeksit të Hapjes **nga 25% deri në 50% kanë 37 NJVL** mes të cilave nëntë janë më të mëdha dhe 28 janë më të vogla, që krahasuar me vitin 2022 paraqet **një rritje për 6 NJVL**.

Në fund, **përmbushje nën 25% të treguesve të Indeksit të Hapjes kanë 11 NJVL**, duke përfshirë një NJVL më të madhe dhe 10 NJVL më të vogla me më pak se 30,000 banorë, që është një **rënie për 31 NJVL krahasuar me vitin 2022**.

Sipas këtyre të dhënave, mund të konkludojmë se megjithëse NJVL-të më të mëdha që kanë më shumë burime njerëzore dhe financiare janë zakonisht më të suksesshme, megjithatë, angazhimi i individëve nga administrata lokale ka një ndikim të madh në hapjen e institucionit.

Rezultatet e NJVL-ve për sa i përket matjes së Indeksit të Hapjes për vitin 2024 janë paraqitur në tabelën 1.

⁴ Regjistrimi i popullsisë, amvisërive dhe banesave në Republikën e Maqedonisë së Veriut, 2021. Enti Shtetëror i Statistikës. Gjetend në: https://www.stat.gov.mk/publikacii/2022/POPIS_DZS_web_MK.pdf

Tabela 1. Lista e renditjes së NJVL-ve në bazë të përqindjes së hapjes sipas Indeksit të Hapjes për vitin 2024

Renditja	Njësia e vetëqeverisjes lokale	% e hapjes
1	Manastiri	67%
2	Dellçeva	66%
3	Demir Hisari	64%
4	Velesi	60%
5	Vallandova	59%
6	Berova	58%
	Kriva Pallanka	
	Prilepi	
7	Vasileva	56%
8	Koçani	55%
9	Gjevgjelia	54%
	Gradskoja	
10	Ohri	53%
11	Gazi Baba	52%
	Kavadari	
12	Demir Kapia	49%
	Karposhi	
13	Zërnovci	48%
14	Novaci	47%
15	Aerodromi	46%
	Kërçova	
	Kumanova	
16	Ilindeni	44%
17	Bogdanci	43%
	Vinica	
	Konçeja	
	Strumica	
	Qendra Zhupa	
18	Dibra	42%
	Debërca	
	Shtipi	
19	Bërvenica	41%

	Sveti Nikoleja	
20	Karbinci	40%
	Tetova	
21	Kisella Voda	39%
22	Krusheva	37%
	Probishtipi	
	Qendra	
NËN MESATAREN		
23	Buteli	36%
	Vevçani	
	Likova	
24	Tearca	35%
25	Gostivari	34%
	Negotina	
	Novo Sella	
26	Bosillova	33%
	Radovishi	
27	Qyteti i Shkupit	32%
	Zhelina	
	Mavrova dhe Rostusha	
	Makedonski Brod	
	Pehçeva	
28	Mogilla	31%
	Çashka	
29	Kratova	30%
30	Resnja	29%
	Çeshinova– Oblesheva	
31	Dojrani	27%
	Gjorçe Petrovi	
	Zelenikova	
	Makedonska Kamenica	
32	Saraji	26%
	Struga	
33	Dollneni	25%
34	Pllasnica	24%
35	Jegunovca	23%

36	Nagoriçani i Vjetër	21%
37	Haraçina	20%
	Petroveci	
38	Vrapçishti	19%
	Çairi	
39	Bogovina	18%
	Rankovca	
40	Llozova	17%
41	Shuto Orizareja	16%
42	Çußer Sandeva	15%
43	Rosomani	14%
44	Krivogashtani	13%
	Studenica	
45	Sopishteja	7%

Në drejtim të përmirësimit të hapjes së saj, në fillim të vitit 2024, komuna e Kisella Vodës u bë e vetmja NJVL në vend që është anëtare e Partneritetit për pushtet të hapur lokal⁵. Për këtë qëllim, komuna ka nisur procesin e krijimit të Këshillit të komunës për Partneritet të pushtetit të hapur lokal 2024-2028, qëllimi i të cilit është të mbështesë transparencën dhe hapjen e komunës, si dhe të përgatisë angazhimet për “rritje të transparencës” dhe “përmirësimin e pjesëmarrjes digjitale të qytetarëve”.⁶

1.2 TRANSPARENCA

Transparenca dhe llogaridhënia janë një nga parimet kryesore të qeverisjes së mirë që duhet të jetë baza e punës së vetëqeverisjes lokale, me qëllim të rritjes së besimit të qytetarëve në vendimet dhe aktivitetet e autoriteteve lokale. Vetëm kur qytetarët të kenë qasje në informatat nga NJVL-të dhe kur ata të mund t’i monitorojnë aktivitetet e përfaqësuesve të tyre të zgjedhur, do të mund të themi se kemi ndërtuar një kulturë lokale të hapjes dhe gjithëpërfshirjes. Ndërtimi i një kulture të hapjes çon në mbështetje më të madhe publike dhe pjesëmarrje më të madhe në proceset vendimmarrëse, gjë që është e nevojshme për një qeverisje efektive dhe të përgjegjshme. Njëkohësisht, rritja e transparencës dhe llogaridhënies është thelbësore në

⁵ Partneritetet për qeverisje të hapur (PQH) është iniciativë multilaterale globale në kuadër të së cilës qeveritë dhe organizatat e shoqërisë civile zotohen për qeveri që janë më të hapura dhe më të përgjegjshme ndaj qytetarëve.

Partneriteti për qeverisje të hapur Maqedonia e Veriut. Gjetet në: <https://ovp.gov.mk/>

⁶ Thirrje për anëtarësim të përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile në Këshillin e komunës së Kisella Vodës për Partneritet për pushtet të hapur Lokal 2024-2028. Komuna e Kisella Vodës. Gjetet në: <https://opstinakiselavoda.gov.mk/wp-content/uploads/2024/07/Povik55.pdf>

parandalimin e korrupsionit dhe keqpërdorimit të pushtetit, gjë që kontribuon më tej për një cilësi më të mirë të jetës për qytetarët.

Një hap në drejtim pozitiv është ajo se në vitin 2024 NJVL-të kanë **vlerësimin mesatar më të lartë në fushën e transparencës (46%)** që është një rritje prej 12% krahasuar me vitin 2022. Ndonëse ky rezultat tregon një rritje të nivelit të transparencës midis NJVL-ve, megjithatë mbetet fakti se deklarativisht të gjitha NJVL-të zotohen për një transparencë më të madhe, e në thelb, vetëm një pjesë e tyre i publikojnë të gjitha informacionet e nevojshme në lidhje me punën e tyre.

Si institucion i parë të cilit i drejtohen qytetarët, pushteti lokal duhet ta përmirësojë ndjeshëm transparencën e tij duke publikuar në mënyrë proaktive sa më shumë informacion në faqet e tyre të internetit e tij. Publikimi dhe qasja në informata për punën e NJVL-ve, buxhetet, kontratat, vendimet e punësimit dhe furnizimet publike nëpërmjet internetit, e forcojnë kontrollin e jashtëm nga organizatat e shoqërisë civile, ekspertët dhe publiku, dhe paraqesin një burim kyç të informatave për cilësinë e qeverisjes.

Megjithëse Ligji për qasje të lirë në informatat me karakter publik⁷ ofron një bazë të mirë për një kuptim më të madh të transparencës aktive ose të gjithë asaj që duhet të publikohet në faqet e internetit të NJVL-ve, nevojitet një zbatim më i plotë i ligjit, veçanërisht nga ana e autoriteteve lokale. Me rritjen e **kërkesave të qytetarëve për qasje të lirë në informatat me karakter publik për punën e NJVL-ve**⁸, rritet edhe nevoja për transparencë proaktive nga ana e tyre.


Në këtë fushë, si më e përkushtuara ndaj **transparencës** këtë vit u tregua **komuna e Berovës (79%)**, ndërsa vlerësim më të dobët kishte **komuna e Sopishtes (14%)**. Këto rezultate përputhen gjithashtu me rezultatet e Indeksit të transparencës aktive për vitin 2024⁹ ku komuna e Sopishtes renditet në vendin e parafundit me transparencë aktive “të dobët”, ndërsa NJVL-të të cilat ky hulumtim i vlerëson si më transparentet renditen lart në kategorinë më të lartë, gjegjësisht transparencë aktive “shumë të mirë”.

⁷ Ligji për qasje të lirë në informatat me karakter publik. Agjencia për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik. Gjetet në: <https://tinyurl.com/3avvkrfw>

⁸ Raporti Vjetor për vitin 2023. Agjencia për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik. Gjetet në: <https://aspi.mk/wp-content/uploads/2024/04/godisen-izvestaj-2023-komplet.pdf>

⁹ Indeksi i Transparencës Aktive 2024. Qendra për Komunikime Qytetare. Gjetet në: https://www.ccc.org.mk/images/index_aktivna_transparencynost_2024.pdf

NJVL-të më transparente sipas Indeksit të Hapjes në vitin 2024



Infografiku 5. NJVL-të më transparente sipas Indeksit të Hapjes për vitin 2024

Duhet të theksojmë se gjatë hulumtimit u vu re se një numër i madh informacionesh, dokumentesh dhe të dhënash të rëndësishme për punën e NJVL-ve publikohen vetëm në buletinet zyrtare dhe jo gjithmonë në format të hapur. Kjo nuk rezulton të jetë një praktikë e mirë në punën e NJVL-ve, sepse të dhënat e publikuara në këtë mënyrë janë shumë të vështira për t'u gjetur dhe përpunuar, gjë që nuk e përmbush qëllimin e tyre bazë - informimin e qytetarëve. Për të qenë më lehtë të arritshme, të parashikueshme dhe të krahasueshme, **përveç buletineve zyrtare, të gjitha të dhënat dhe informacionet duhet të jenë të strukturuar mirë dhe të publikohen drejtpërdrejt në kuadër të menyve dhe seksioneve të faqeve të internetit të NJVL-ve.**

Në fushën e transparencës, treguesit janë të organizuar në katër nënfusha:

- 'Angazhimi për transparencë dhe llogaridhënie', i cili përfshin politikat e transparencës dhe llogaridhënies dhe trajnimeve të vazhdueshme për atë temë;
- 'Informacione organizative' që kanë të bëjnë me strukturën e NJVL-së, kompetencat bazë dhe çështjet kadrovike;
- 'Marrja e vendimeve' nga Këshilli dhe kryetari/ja i/e komunës;
- 'Transparenca financiare' e cila përfshin prokurimet publike, buxhetin, llogaritë përfundimtare dhe raportet financiare.

1.2.1. Angazhimi për transparencë dhe llogaridhënie

Ekzistenca e një politike të qartë për transparencë, llogaridhënie dhe qasshmëri të NJVL-së tregon se ajo është e përkushtuar ndaj qytetarëve. Një pjesë shumë e vogël e NJVL-ve i qasen në mënyrë strategjike promovimit të transparencës dhe llogaridhënies në komunitetin lokal ku veprojnë, gjegjësisht vetëm **gjashtë NJVL raportuan se kanë politikë, procedurë ose strategji përmes së cilës e menaxhojnë transparencën e tyre**. Si një shembull të mirë mund ta veçojmë **komonën e Dellçevës**, e cila ka **Program për komunikim me publikun dhe promovimin e komunës së Dellçevës**¹⁰, përmes të cilit e rregullon hapjen dhe transparencën e saj ndaj qytetarëve.

Transparencën dhe llogaridhënien ndaj qytetarëve, NJVL-të e promovojnë nëpërmjet mjeteve themelore për informimin e qytetarëve si detyrim ligjor i tyre, ndërsa qasshmëria dhe funksionaliteti i mjeteve për informim është përcaktim i NJVL-ve për t'i prezantuar informacionet tek qytetarët e saj në mënyrën më të përshtatshme. Publikimi dhe qasja në informata për punën e NJVL-ve, buxhetet, kontratat, vendimet e punësimit dhe furnizimet publike nëpërmjet internetit e forcojnë kontrollin e jashtëm nga organizatat e shoqërisë civile, ekspertët dhe publiku.

Ndryshe nga viti 2022, kur u konstatua se dy NJVL nuk kishin ueb-faqe funksionale, këtë vit **ueb-faqet e të gjitha 81 NJVL-ve ishin të qasshme** edhe atë **të gjitha në domenin gov.mk**. Megjithatë, disa nga NJVL-të që kanë ueb-faqe funksionale janë zhvilluar në një nivel shumë të ulët, ndërsa disa nuk i plotësojnë kërkesat për **sigurinë kibernetike**, e as që kanë **politika të privatësisë**. Publikimi i Politikës së privatësisë, përveç që është një detyrim ligjor¹¹, u ofron NJVL-ve një bazë për të fituar besimin e vizitorëve në faqet e tyre të internetit nëpërmjet informimit transparent për atë se cilat të dhëna të tyre i mbledhin dhe i përdorin, në çfarë mënyre dhe për çfarë qëllimi.

Edhe pse kanë faqe zyrtare të internetit, gjatë monitorimit **të faqeve të internetit të Gostivarit dhe Bosillovës u vërejt se ato nuk janë përditësuar për më shumë se tre muaj**, ndërsa për dallim nga 62 NJVL që publikojnë rregullisht informata, **17 NJVL nuk i kishin përditësuar faqet e tyre zyrtare të internetit në tre muajt e fundit**. Të gjitha faqet e internetit përmbajnë **mjet kërkimi funksional** përveç faqeve të internetit të **shtatë NJVL-ve** ndërmjet të cilave edhe **Tearca, Llozova, Makedonski Brodi, Mogilla, Petroveci, Zelenikova dhe Zërnovci**.

Sipas Ligjit për përdorimin e gjuhëve¹², përveç gjuhës maqedonase si gjuhë zyrtare në vend, në NJVL-të gjuhë zyrtare është edhe gjuha që e përdorin së paku 20% e qytetarëve, ndërsa për gjuhët që i flasin më pak se 20% të qytetarëve në një NJVL të caktuar vendosin organet e asaj NJVL-je. Konstatimet tona tregojnë se disa NJVL nuk i përditësojnë rregullisht të gjitha versionet gjuhësore të faqeve të tyre të internetit, gjegjësisht informacioni nuk publikohet rregullisht në të gjitha gjuhët zyrtare të NJVL-së. Megjithëse sipas regjistrimit të fundit të popullsisë NJVL-të kanë detyrim ligjor, **dy NJVL nuk kanë version në gjuhë të dytë**, ndërsa **pesë NJVL nuk e kanë**

¹⁰ Programi për komunikim me publikun dhe promovimin e Komunës së Dellçevës për vitin 2024. Komuna e Dellçevës. Gjetet në: <https://www.delcevo.gov.mk/wp-content/uploads/2024/02/1-Programa-odnosi-so-javnost-2024-Delchevo.pdf>

¹¹ Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Gjetet në: <https://azlp.mk/wp-content/uploads/2022/11/zakon-za-zastita-na-licnite-podatoci.pdf>

¹² Ligji për Përdorimin e Gjuhëve. Gjetet në: <https://dejure.mk/zakon/zakon-za-upotreba-na-jazicite-1>

përditësuar versionin e gjuhës së dytë në tre muajt e fundit dhe dy NJVL nuk e kanë përditësuar versionin e gjuhës së dytë për më shumë se tre muaj.

Hulumtimi ynë tregoi se disa NJVL kanë krijuar një praktikë të investimit në ngritjen e kapaciteteve të punonjësve të tyre, por vetëm për tema të caktuara. Në fakt, në vitin e fundit, punonjësit nga **65 NJVL kishin marrë pjesë në trajnime për qasje në informata me karakter publik**, por madje **73 NJVL nuk kanë marrë pjesë në trajnime për të dhënat e hapura**. Për më tepër, vetëm **20 NJVL raportuan se kanë emëruar Zyrtar për të dhënat e hapura dhe 22 NJVL u përgjigjën se publikojnë të dhëna të hapura në Portalin nacional të të dhënave të hapura**¹³.

1.2.2. Informacioni për organizatën

Disponueshmëria e informacionit për organizatën për kompetencat, dokumentet për punën dhe çështjet kadrovike të NJVL-së është detyrim ligjor. Nëpërmjet këtyre të dhënave, qytetarët marrin informacion themelor për funksionimin e NJVL-së, gjë që u ndihmon atyre të krijojnë një pasqyrë të përgjithshme të funksionimit të NJVL-së, fushave të saj të veprimit, si dhe për qasshmërinë e nëpunësve komunalë.

Madje **14 NJVL nuk publikojnë organogram**, i cili tregon në mënyrë skematike renditjen hierarkike të njësive të brendshme të NJVL-së dhe të pozicioneve, gjegjësisht të vendeve të punës në çdo njësi dhe sektor. Gjithsej **36 NJVL nuk publikojnë informacione për kompetencat e NJVL-së**, të cilat janë të përcaktuara sipas Ligjit për vetëqeverisjen lokale,¹⁴ ndonëse publikojnë informacione për kompetencat e kryetarit/es të/së komunës ose të Këshillit, e në disa raste madje publikohen edhe kompetencat e çdo organi të NJVL-së. **Kompetencat e NJVL-së** duhet të përmbledhen dhe të publikohet në menynë me informacionin themelor për NJVL-të, në mënyrë që qytetarët të dinë se për çfarë lloj çështjesh dhe shërbimesh mund t'u drejtohen autoriteteve komunale.

Përveç kësaj, duhet të publikohet **lista e ligjeve që kanë të bëjnë me kompetencat e NJVL-ve** me mundësinë e shkarkimit dhe kërkimit të tyre, një praktikë që **nuk e kanë madje 39 NJVL**.

NJVL-të janë më të rregullta në publikimin e **biografisë së kryetarit/es të/së komunës**, të cilat mund të gjenden në faqet e internetit të **75 NJVL-ve**, dhe të **statuteve**, të cilat janë publikuar në faqet e internetit të **70 NJVL-ve**.

Ndërsa **71 NJVL** kanë publikuar **informacion të plotë për anëtarët e Këshillit me emër, foto dhe detaje për kontakt**, madje **30 NJVL nuk e publikojnë Rregulloren e punës së Këshillit komunal**, ndërsa **22 NJVL nuk kanë publikuar informacion për komisionet dhe organet e punës së Këshillit**.

Informacion të plotë për **emrat, pozicionet dhe detajet e kontaktit të nëpunësve administrativë** publikojnë **64 NJVL**, ndërsa në faqet e internetit të shtatë NJVL-ve ky informacion nuk është në dispozicion fare.

¹³ Portali për të dhënat e hapura. Gjendet në: <https://data.gov.mk/>

¹⁴ Ligji i vetëqeverisjes lokale. Gjendet në:

<https://mls.gov.mk/images/laws/zakoni/Zakon%20za%20lokalnata%20samouprava.pdf>

Përveç nëpunësve administrativë, NJVL-të duhet të jenë transparente edhe për punësimet e përkohshme mbi baza të ndryshme, dhe për këtë është e nevojshme të publikohet edhe lista e personave të punësuar me kontrata në vepër, kontrata autoriale ose kontrata për punë të përkohshme. Ky informacion e bën të mundur matjen e transparencës së NJVL-ve si në aspektin financiar, ashtu edhe në aspektin e luftës kundër korrupsionit, konfliktit të interesit dhe nepotizmit. **Fatkeqësisht, të rralla janë NJVL-të që publikojnë informacion të plotë për personat e angazhuar me kontrata në vepër, kontrata për punë të përkohshme dhe kontrata autoriale.**

Për sa i përket transparencës së informacionit për organizatën nga ndërmarrjet publike, më konkretisht nga ndërmarrjet publike komunale, **informacion mbi aksionet e NJVL-ve në ndërmarrjet publike** publikojnë më pak se gjysma e NJVL-ve (38). Disponueshmëria e këtij informacioni është jashtëzakonisht e rëndësishme në situatat kur NJVL-të ofrojnë shërbime publike nëpërmjet partneriteteve publiko-private në bashkëpunim me shoqëritë tregtare, si dhe për ndërmarrjet publike të formuara me bashkëpunim ndërkomunal. **Statutet për ndërmarrjet publike komunale janë në dispozicion vetëm në 15 NJVL** në faqet e tyre të internetit ose në faqet e internetit të ndërmarrjeve publike komunale, ndërsa informacione rreth **anëtarëve të këshillave drejtues dhe mbikëqyrës të ndërmarrjeve publike komunale** janë të disponueshme në 13 NJVL plotësisht, ndërsa në tetë NJVL pjesërisht.

Megjithëse të gjitha informacionet rreth bashkësive urbane dhe lokale duhet të jenë të disponueshme për publikun, vetëm 36 NJVL publikojnë informacione për emrat dhe kontaktet e kryetarëve të bashkësive urbane dhe lokale.

1.2.3. Marrja e vendimeve

Qytetarët zakonisht u drejtohen NJVL-ve dhe perceptimi i tyre për këtë institucion zakonisht përqendrohet te kryetari/ja i/e komunës, ndërkohë që shpeshherë neglizhohet roli i këshillave komunalë si miratues të vendimeve dhe politikave. Rritja e disponueshmërisë së informacionit për vendimet e Këshillit dhe informimi në kohë për punën e tyre do t'u mundësojë qytetarëve që të përfshihen më shumë në procesin e miratimit të politikave publike në nivel lokal.

Konkluzioni i përgjithshëm është se një numër i madh i NJVL-ve nuk kanë krijuar një sistem funksional për publikimin e informacionit që rrjedh nga puna e Këshillave, kurse ato që kanë sisteme të tilla, rrallëherë i përdorin. **Të gjitha rendet e ditës për seancat e Këshillit** për vitin e fundit janë të disponueshme në 43 NJVL, ndërsa në 13 NJVL në dispozicion janë gjysma ose më pak se gjysma e rendeve të ditës. **Procesverbalet e seancave** për vitin e fundit janë të disponueshme plotësisht në 19 NJVL dhe pjesërisht në gjashtë NJVL, ndërsa **vendimet e miratuara nga këshillat** janë të disponueshme plotësisht në 36 NJVL dhe pjesërisht të disponueshme në nëntë NJVL, zakonisht në buletinet zyrtare.

Nëse e marrim parasysh disponueshmërinë dhe efikasitetin e teknologjive të reja, mundësia për ndjekje e **transmetimit të drejtpërdrejtë me zë dhe video të seancave** mund ta lehtësojë ndjeshëm monitorimin e punës së këshillave dhe vendimmarrjen në nivel lokal. Një mundësi të tillë e ofrojnë vetëm 31 NJVL, ndërsa **regjistrime me zë dhe video nga seancat e vitit të kaluar** janë publikuar plotësisht nga 19 NJVL, kurse më pak se gjysma në katër NJVL.

Për të rritur vetëdijen, gjegjësisht për të reduktuar mundësinë e ndikimit të paligjshëm përmes lobimit të aktorëve të ndryshëm në proceset vendimmarrëse të këshillave dhe kryetarëve/eve të komunave, është i nevojshëm publikimi në kohë i komunikatave për shtyp për punën e tyre. Kështu, vetëm në tre muajt e fundit **pesë NJVL** kishin të paktën një **komunikatë ose deklaratë për shtyp nga seanca e Këshillit**, ndërsa publikimi i **komunikatave për takimet e realizuara zyrtare me informacion të detajuar nga takimi** është **praktikë e rregullt në 26 NJVL** dhe **praktikë e kohëpaskohshme në 34 NJVL**.

1.2.4. Transparenca financiare

Transparenca financiare është aspekt kryesor i punës së NJVL-ve, ndërsa disponueshmëria e informacionit financiar si buxhetet, llogaritë përfundimtare, raportet financiare dhe prokurimet publike janë detyrim ligjor për NJVL-të dhe ndërmarrjet publike. Buxheti, si një mjet kryesor për realizimin e të gjitha aktiviteteve dhe për funksionimin e rregullt të NJVL-së, duhet të publikohet së bashku me të gjitha dokumentet shoqëruese dhe informacionin e nevojshëm për miratimin dhe ekzekutimin e tij.

Gjatë hulumtimit, **buxhetin komunal** për vitin aktual nuk e kanë publikuar **17 NJVL**, e gjithashtu një dukuri e rrallë është edhe **buxheti qytetar**, i cili për vitin aktual **nuk është në dispozicion madje në 59 NJVL**. Duke pasur parasysh nivelin e edukimit financiar të popullatës, veçanërisht tek të rinjtë¹⁵, disponueshmëria e buxhetit qytetar, të paraqitur sipas fushave dhe në mënyrë të kuptueshme, është me rëndësi thelbësore që qytetarët të kuptojnë se si dhe për çfarë qëllimi ndahen mjetet financiare në vendbanimin e tyre. Në të njëjtin drejtim, nevojitet një angazhim më i madh i NJVL-ve për publikimin e **planeve dhe programeve financiare vjetore për realizimin e buxhetit**, të cilat përveç në buletinet zyrtare duhet të vendosen në një vend të dukshëm në faqet e tyre të internetit. Vetëm **23 NJVL** e ndjekin këtë praktikë të mirë.

Në këtë fushë monitorohet edhe nëse **vendimi për buxhetin i është dorëzuar Këshillit para datës 1 dhjetor të vitit aktual**, për të cilën gjë pozitivisht u përgjigjën **14 NJVL** nga 42 NJVL që iu përgjigjën pyetësorit.

Një tendencë rënëse shihet në publikimin e **raporteve tremujore** për realizimin e buxhetit ku **47 NJVL** kanë publikuar raporte tremujore **për dy vitet e fundit**, ndërsa vetëm **pesë NJVL** kanë publikuar raporte tremujore **për vitin e fundit**. Situata është e ngjashme edhe me **llogaritë përfundimtare**, ku **51 NJVL** i kanë publikuar llogaritë përfundimtare **për dy vitet e fundit**, ndërsa vetëm **pesë NJVL** i kanë publikuar llogaritë përfundimtare **për vitin e fundit**.

Pak më pak se gjysma e NJVL-ve (**38**) publikojnë informacione rreth **marrjes së huave** nga NJVL-ja të cilat zakonisht gjenden në llogaritë përfundimtare ose në raportet financiare, andaj duke

¹⁵ “Rezultatet tregojnë se pak më shumë se 70% e të anketuarve nuk kanë demonstruar njohuri të mjaftueshme financiare në të gjitha fushat e përcaktuara. Me fjalë të tjera, vetëm rreth 30% e të anketuarve mund të konsiderohen të arsimuar financiarisht, ndërsa vetëm 6% kanë njohuri të larta financiare”.

pasur parasysh ngarkesën e madhe me borxhe të shumicës së NJVL-ve, për shkak të së cilës përballen me vështirësi në përmbushjen e kompetencave të tyre, është e rëndësishme që informacionet e tilla të paraqiten publikisht në mënyrë të kuptueshme.

Transparencën e **prokurimeve publike**, një pjesë e NJVL-ve e kanë trajtuar duke integruar pjesë të Portalit për prokurime publike të Byrosë për Prokurime Publike. Megjithatë, te një pjesë më e vogël e NJVL-ve vërehet jokonsekuencë në disponueshmërinë e dokumenteve që lidhen me prokurimet publike. Në fakt, **për dy vitet e fundit, 61 NJVL** i kanë publikuar **planet për prokurime publike**, **65 NJVL** i kanë publikuar **thirrjet për prokurime publike**, **55 NJVL** i kanë publikuar **vendimet** për prokurime publike në formën e njoftimeve, dhe **62 NJVL** i kanë publikuar **kontratat** për prokurime publike. Dokumentet që kanë të bëjnë me prokurimet publike vetëm **për një vit** janë në dispozicion te një numër dukshëm më i vogël institucionesh, gjegjësisht **planet** për prokurime publike janë në dispozicion në **pesë NJVL**, **thirrjet te një NJVL**, **vendime dhe kontratat në dy NJVL**, që është rezultat i fillimit të një praktike të re për publikimin e informatave të tilla ose i braktisjes së praktikës së mëparshme të publikimit. **Anekset** e kontratave janë në dispozicion në **51 NJVL**, ndërsa **raporte për realizimin e planeve për prokurimet publike**, kryesisht në formën e një liste të kontratave të realizuara të integruara nga Portali për prokurime publike, kanë **42 NJVL**.

Vetëm **12 NJVL** publikojnë informacione rreth **rrogave të funksionarëve**, me atë që as transparenca e **kompensimeve të këshilltarëve** nuk është në nivel të lartë. Gjegjësisht, informacioni për kompensimet e anëtarëve të Këshillit është në dispozicion vetëm për qytetarët e **12 NJVL-ve**, ndërsa **Rregullorja për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit dhe mëditjeve për udhëtimet zyrtare brenda dhe jashtë vendit për këshilltarët dhe nëpunësit shtetërorë** është në dispozicion vetëm në **nëntë NJVL**.

Raportet e Entit Shtetëror të Revizionit në lidhje me punën e NJVL-ve mund të gjenden në faqet e internetit të **21 NJVL-ve**.

Gjatë menaxhimit të pronës komunale dhe ofrimit të shërbimeve, NJVL-të shpesh bashkëpunojnë me persona juridikë ose fizikë **nëpërmjet tenderëve publikë, koncesioneve ose partneriteteve publiko-private**. Transparenca në këto procedura është thelbësore për parandalimin e keqpërdorimit dhe konfliktit të interesave, e duke qenë se këto procedura nuk përfaqësohen shpesh, nëpërmjet hulumtimit verifikohet nëse të paktën një informacion nga ndonjëra nga tre kategoritë është publikuar në faqen e internetit të NJVL-së, nga të cilat **dy informacione** janë në dispozicion vetëm në **një NJVL** dhe **një informacion** është në dispozicion në **18 NJVL**.

Në kuadër të buxheteve dhe aktiviteteve të tyre, NJVL-të ofrojnë herë pas here mbështetje financiare për shoqatat e qytetarëve dhe klubet sportive, andaj është e nevojshme që procesi i përzgjedhjes dhe ndarjes së fondeve të jetë transparent, përmes thirrjes publike dhe vendimit, me emrat e organizatave që kanë marrë fonde, projektet dhe kriteret e përzgjedhjes. Kështu, megjithëse **41 NJVL** kanë publikuar **të paktën një thirrje për projekte për organizatat e shoqërisë civile për vitin e kaluar, vendime për fondet e ndara për organizatat e shoqërisë civile** kanë publikuar vetëm **18 NJVL**.


Nëpërmjet kësaj fushe e vlerësojmë edhe transparencën financiare të ndërmarrjeve publike komunale, e kështu në **më pak se 20% të NJVL-ve** janë në dispozicion **raportet vjetore ose**

Ilogaritë përfundimtare të ndërmarrjeve publike komunale. Akti me të cilin përcaktohen **çmimet për shërbimet** e ndërmarrjeve publike komunale është në dispozicion në **12 NJVL**, ndërsa akti për **përdorimin e të ardhurave të realizuara** të ndërmarrjes publike komunale është në dispozicion në **tre NJVL**.

1.3 VETËDIJËSIMI

Vetëdijësimi i referohet cilësisë së planifikimit, programimit, monitorimit dhe vlerësimit të politikave nga institucionet. Parashikueshmëria e politikave publike është thelbësore për qytetarët, andaj synimet e NJVL-së duhet të planifikohen në një dokument strategjik të disponueshëm publikisht, efikasiteti i të cilit duhet të monitorohet dhe vlerësohet rregullisht sipas treguesve të përcaktuar të performancës.

Megjithëse në krahasim me vitin 2022 (13%) ka një përmirësim **(21%)**, **vetëdijësimi** mbetet fusha më e neglizhuar në agjendën e vetëqeverisjes lokale që tregon për cilësinë e dobët të planifikimit, programimit, monitorimit dhe vlerësimit të politikave që i zbatojnë NJVL-të.



Infografiku 6. NJVL-të më të vetëdijësuara sipas Indeksit të Hapjes në vitin 2024

Komuna e Gjevgjelisë (71%) u dëshmuar si më e përkushtuar për planifikimin, programimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave që i zbaton, së bashku me komunat e **Dellçevës (68%)**, **Manastirit (65%)**, **Kriva Pallankës (57%)**, **Ohrit (57%)**, **Vasilevës (56%)**, **Gradskos (53%)**, **Karbincit (52%)** dhe **Novacit (53%)** të cilat përmbushin **mbi 50%** të treguesve në këtë fushë. Megjithatë, madje **20 NJVL nuk publikojnë asnjë informacion që identifikohet me këtë fushë**, duke përfshirë Jegunovcën, Çeshinovën – Obleshevën, Tetovën, Studeniçanin, Sopishten, Sarajin, Rosomanin, Llozovën, Makedonska Kamenicën, Mogillën, Negotinën, Novo Sellën, Petrovecin, Pehçevën, Pllasnicën, Rankovcin, Vevçanin, Dibrën, Dojranin, dhe Zhelinën, të cilat automatikisht kanë

përmbushje prej 0% të kriterëve. Ky numër megjithatë është **për 12 NJVL më i vogël se numri i NJVL-ve që nuk kanë publikuar asnjë informacion për këtë fushë në vitin 2022.**

Fusha e vetëdijësimit i përfshin nënfushat e mëposhtme:

- 'Planifikimi dhe programimi', gjegjësisht zhvillimi i programeve për punë të NJVL-ve, dokumenteve strategjike për zhvillim dhe zhvillimi i treguesve për monitorim;
- 'Monitorimi dhe vlerësimi', që përfshin zbatimin e planeve vjetore, raportimin, përdorimin e treguesve për të matur suksesin e zbatimit të politikave.

1.3.1. Planifikimi dhe programimi

Dokumentet strategjike për zhvillim dhe programet për punën e kryetarit/es të/së komunës dhe të Këshillit janë dokumente të rëndësishme në nivel lokal që tregojnë për një qasje të planifikuar për ndërtimin e politikave publike lokale në shërbim të nevojave të qytetarëve.

Fatkeqësisht, madje **47 NJVL nuk i publikojnë programet aktuale vjetore** jashtë nga buletinet zyrtare, njëjtë sikurse në **70 NJVL nuk janë në dispozicion programet vjetore të këshillave komunale për vitin aktual**. Në linjën e njëjtë, vetëm **tetë NJVL** kanë publikuar **program vjetor të investimeve** për vitin aktual të ndërmarrjeve publike komunale.

Programet vjetore dhe dokumentet strategjike të krijuara duhet të bazohen në tregues të matshëm të suksesit në mënyrë që të monitorojnë përmbushjen e tyre dhe në bazë të vlerësimit të arritjeve apo sfidave, të mund të gjejnë zgjidhje për zgjidhjen e çështjeve ekzistuese. Megjithatë, kjo nuk është praktikë në vetëqeverisjen lokale, gjegjësisht **tregues të suksesit gjatë zhvillimit të programeve të tyre vjetore** përdorin **10 NJVL** dhe **ndërmarrje publike komunale në 11 NJVL**.

Planifikimi afatgjatë i NJVL-ve duhet të bëhet duke e inkorporuar vizionin e tij për zhvillimin e NJVL-së në një strategji zhvillimi, plan zhvillimi ose dokument tjetër të ngjashëm. Vetëm **29 NJVL** kanë zhvilluar **strategji për zhvillim ose plan për zhvillim** ku i vendosin synimet e tyre për vitin aktual, ndërsa vetëm **18 NJVL** kanë zhvilluar **plan veprim** për realizimin e tyre.

Në linjën e njëjtë, vetëm **26 NJVL** publikojnë **tre ose më shumë strategji sektoriale komunale** për dallim nga **24 NJVL**, të cilat publikojnë **një deri në dy strategji**, ndërsa **31 NJVL-të nuk publikojnë fare strategji sektoriale komunale**.

1.3.2. Monitorimi dhe vlerësimi

Planifikimi strategjik duhet të plotësohet me një metodologji monitorimi dhe vlerësimi që përmban tregues specifikë, të matshëm, të arritshëm, relevantë dhe të kufizuar në kohë për konfirmimin e progresit në një fushë të caktuar, e cila është edhe bazë për politikat publike të bazuara në fakte, përmes të cilave konfirmohet sukcesi i politikës publike.

Konstatimet tregojnë se NJVL-të kanë një mungesë evidente të monitorimit dhe vlerësimit të politikave publike lokale, ku përveç vullnetit politik nevojiten edhe kapacitete njerëzore dhe ekspertizë në vetë administratën komunale, por edhe në komunitetin lokal.

Dëshpërues është fakti që vetëm qytetarët e **tetë NJVL-ve** mund të kenë **qasje në aktivitetet e kryetarëve/eve të komunave përmes raportit vjetor të kryetarëve/eve të komunave**, dhe vetëm qytetarët e **dy NJVL-ve** mund të kenë qasje në **raportet vjetore për punën e këshillave** në vendbanimin e tyre. Situata është e ngjashme edhe me **raportin vjetor për punën e ndërmarrjeve publike komunale**, ku raportet vjetore janë të disponueshme vetëm në **12 NJVL**.


Përderisa **10 NJVL** konfirmuan se **përdorin tregues gjatë përgatitjes së programeve të tyre vjetore**, edhe më pak, gjegjësisht vetëm **shtatë NJVL** përdorin tregues në hartimin e raporteve të tyre vjetore të performancës.

1.4 QASSHMËRIA

Qasshmëria është një element kryesor i qeverisjes së mirë, duke mundësuar politika lokale transparente, gjithëpërfshirëse dhe llogaridhënëse. Legjislacioni kombëtar i konfirmon politikat e qasshmërisë përmes të drejtës për qasje të lirë në informatat me karakter publik, iniciativat për të dhëna të hapura dhe detyrimet për zbatimin e proceseve konsultative, duke përfshirë krijimin e organeve në të cilat marrin pjesë qytetarët, komunitetet lokale dhe referendumet për çështjet në kompetencë të vetëqeverisjes lokale.

Krahasuar me hulumtimin e vitit 2022 (24%), konstatimet tregojnë një përmirësim në **qasshmërinë (32%)** e NJVL-ve, gjegjësisht në ofrimin e qasjes publike në informatat me karakter publik dhe mekanizmave efikase për përfshirjen qytetare për t'u mundësuar qytetarëve që të përfshihen më lehtë dhe më thelbësisht në marrjen e vendimeve në nivel lokal dhe në formësimin e një jete më të mirë në komunitet. Sipas hulumtimit të këtij viti, NJVL-ja më e qasshme është **komuna e Demir Hisarit** me përmbushje prej **70%** të treguesve të qasshmërisë.

NJVL-TË MË TË QASSHME SIPAS INDEKSIT TË HAPJES NË VITIN 2024



Infografiku 7. NJVL-të më të qasshme sipas Indeksit të Hapjes në vitin 2024

Kjo fushë përfshin tre nënfusha:

- 'Qasja në informata dhe shërbime', e cila përfshin qasje të lirë në informatat me karakter publik, qasje në shërbime dhe informim të qytetarëve për punën e NJVL-së;
- 'Konsultimet publike' ku bëjnë pjesë mundësitë e ndryshme për përfshirjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes nga ana e kryetarëve/eve të komunave dhe këshillave, punën e NJVL-ve dhe planifikimin e buxhetit;
- 'Ndërveprimi me qytetarët', gjegjësisht mundësitë për komunikim të dyanshëm ndërmjet NJVL-së dhe qytetarëve nëpërmjet mjeteve të dedikuara dhe mediave sociale, qasshmëria e kryetarëve/eve të komunave dhe autoriteteve komunale.

1.4.1. Qasja në informata dhe shërbime

Parimet dhe praktikatat e mira ndërkombëtare tregojnë se qasja në informacion është e drejtë themelore e qytetarëve të NJVL-së, e në të njëjtin drejtim janë edhe përpjekjet e shtetit nëpërmjet iniciativës Partneriteti për Qeverisje të Hapur. Rregullativa ligjore, e drejtuar kryesisht nga Ligji për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik, por edhe nga Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, i detyron NJVL-të të informojnë rregullisht publikun për punën e tyre, për planet dhe programet që janë të rëndësishme për zhvillimin e NJVL-së, si dhe detyrimet që rrjedhin nga ligji sektorial për krijimin e të dhënave nëpërmjet mbajtjes së regjistrave dhe evidencave. Pastaj, NJVL-të janë të detyruara qytetarëve t'u ofrojnë qasje në informacionin bazë për shërbimet që ua ofrojnë.

Megjithëse ekziston një kornizë pozitive ligjore për qasjen në informatat me karakter publik dhe detyrim për NJVL-të për të publikuar informacione për punën e tyre, nevojitet një kornizë ligjore më e detajuar, e fokusuar ekskluzivisht në vetëqeverisjen lokale në formën e një kodi ose akti nënligjor. Lidhur me realizimin e **së drejtës për qasje të lirë në informatat me karakter publik**, gjithsej **68 NJVL** kanë vendosur **meny të veçantë (seksion)** për publikimin e të gjitha informatave relevante duke përfshirë edhe **listën e informatave me karakter publik** që është në dispozicion në faqet e internetit të **56 NJVL-ve**, të dhëna për **kontakt me personin përgjegjës për qasje në informatat me karakter publik**, të cilat janë të disponueshme në faqet e internetit të **76 NJVL-ve**, dhe **procedurën** për ushtrimin e kësaj të drejte, e cila është publikuar në faqet e internetit të **56 NJVL-ve**. Për shkak të zvogëlimit të numrit të kërkesave për qasje të lirë në informatat me karakter publik, që paralelisht kontribuon në zvogëlimin e punës së administratës publike, për shkak të qasjes më të madhe dhe më të shpejtë në informata, rekomandohet **publikimi i anonimizuar i përgjigjeve në lidhje me kërkesat**, të cilat janë të disponueshme në **18 NJVL**, të cilat rrallëherë anonimizohen.

Është e qartë se NJVL-të nuk janë të përkushtuara për të mbajtur evidencë dhe për të publikuar regjistra, grupe të dhënash dhe informacione nga fusha të ndryshme, të cilat kanë detyrim ligjor t'i krijojnë dhe t'i mbajnë. Kështu, nëse i marrim parasysh gjetjet e hulumtimit tonë dhe **(mos)disponueshmërinë e informatave në faqet e internetit të NJVL-ve**, rezulton se vetëm qytetarët e **12 NJVL-ve** kanë **tregje në territorin e NJVL-së së tyre**, vetëm në **katër NJVL** ka **shtëpi për të moshuarit**, vetëm në **tetë NJVL** ka **institucione për mbrojtjen** e kategorive të ndryshme të qytetarëve, vetëm në **pesë NJVL** ka objekte banimi me drejtues, dhe vetëm në **12 NJVL** ka **transportues dhe mjete motorike për transportin e udhëtarëve dhe mallrave**, që në thelb është

në kundërshtim me realitetin. Gjithashtu, sipas informacioneve të disponueshme në ueb-faqet e NJVL-ve, rezulton se vetëm në **31 NJVL** ka **objekte sportive**, ndërsa vetëm në **24 NJVL** ka **klube sportive**, dhe se vetëm në **23 NJVL** ka **organizata të shoqërisë civile që veprojnë në territorin e tyre**, që përsëri nuk e pasqyron situatën reale.

Ndryshe nga përpjekjet për promovim më të madh të **turizmit** në shtet dhe nëpërmjet kësaj edhe gjenerim të zhvillimit më të madh ekonomik, NJVL-të gjithashtu nuk janë të përkushtuara për të mbajtur evidencë dhe për të publikuar lista të hotelierëve dhe të objekteve të kategorizuara të hotelierisë, veprimtarive të hotelierisë në shkallë të vogël, veprimtarive turistike në shkallë të vogël, listë të shërbimeve në turizmin rural, etnik dhe ekologjik, e as të regjistrave të personave fizikë që ushtrojnë veprimtari turistike, guidave turistike dhe shoqëruesve. Te një pjesë e madhe e NJVL-ve nuk janë publikuar as regjistrat e monumenteve dhe memorialeve përkujtimore, dhe informacione për institucionet komunale në fushën e kulturës. Gjithashtu, rrallë gjenden edhe të dhëna për zonat industriale në territorin e NJVL-së, si dhe për parkingjet dhe deponitë.

Në fushën e **arsimit**, **52 NJVL** publikojnë regjistra për **çerdhet e fëmijëve**, **72 NJVL** për **shkollat fillore** dhe **35 NJVL** për **shkollat e mesme** në territorin e tyre.

Në fushën e **mjedisit jetësor dhe urbanizmit**, organizatat e shoqërisë civile paralajmërojnë se nuk ka të dhëna në vend për numrin e saktë të lejeve të integruara ekologjike -B të lëshuara nga NJVL-të për kompanitë, veprimtaria e të cilave ndikon në mjedisin jetësor, dhe se regjistri¹⁶ që mbahet nga Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor nuk është i përditësuar¹⁷. Gjithashtu, ato theksojnë se NJVL-të nuk kanë praktikë të informimit të qytetarëve për të ardhurat që i realizojnë kompanitë që janë bartëse të lejeve të integruara B, mungesa e transparencës së të cilave e rrit rrezikun për keqpërdorime.¹⁸ Në drejtimin e njëjtë, hulumtimi ynë tregoi se në faqet e internetit të NJVL-ve rrallë mund të gjenden regjistra për lejet e dhëna të integruara ekologjike B, si dhe kadastrat për mjedisin jetësor, licencat e lëshuara për mbeturina, licencat e lëshuara për largimin e automjeteve të dëmtuara dhe të prishura nga rrugët komunale, lejet e lëshuara për vendosjen e objekteve të përkohshme dhe pajisjeve urbane, si dhe të kërkesave të parashtruara për përcaktimin e statusit ligjor të objekteve të paligjshme, regjistrat e ndotësve, krijuesit e zhurmës dhe mbeturinave, si dhe informacione për qendrat grumbulluese të mbeturinave elektrike dhe elektronike.

Në faqet e internetit të **54 NJVL-ve** ka qasje në **propozimet e planeve të detajuara urbanistike**, ndërsa në faqet e internetit të **59 NJVL-ve** mund të gjenden edhe **planet e detajuara urbanistike të miratuara** në territorin e tyre. Ndonëse disa NJVL kanë vendosur link apo baner që të çon në sistemin e procedurave elektronike të planet urbanistike - “e-Urbanizëm”¹⁹, i cili synon të lehtësojë procesin e miratimit të procedurave për planet urbanistike,²⁰ kjo nuk mjafton që

¹⁶ Regjistri i lejeve ekologjike A dhe B të lëshuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor. Gjendet në: <https://www.registers.mk/>

¹⁷ Hulumtim mbi procesin e dhënies së lejeve të integruara ekologjike B. Qendra për Komunikime Qytetare. Gjendet në: <https://ccc.org.mk/images/eko%20dozvoli.pdf>

¹⁸ Po aty.

¹⁹ E-Urbanizëm: <https://www.e-urbanizam.mk/najava.nspj>

²⁰ Sistemi për menaxhim elektronik të procedurës për miratimin e planeve urbanistike - procedurat e iniciuara nga personat fizikë dhe juridikë. Ministria e Transportit dhe Lidhjeve. Gjendet në: <https://tinyurl.com/4s5sj8r5>

qytetarët të kenë një pasqyrë të papenguar në këto të dhëna sepse për t'u regjistruar në sistem duhet të posedohet certifikatë digjitale. Nuk është praktikë as publikimi i **raportit vjetor për lejet e lëshuara të ndërtimit**, i cili është i disponueshëm vetëm në **pesë NJVL**. Regjistrat e emrave të rrugëve dhe numrave të ndërtesave, shesheve, urave dhe objekteve të tjera të infrastrukturës janë të disponueshme vetëm në **dy NJVL**, edhe atë jo të plota.

Megjithëse të gjitha ligjet materiale që kanë të bëjnë me fushat në të cilat vetëqeverisja lokale ka kompetencë për të kryer mbikëqyrje inspektuese përmbajnë detyrim për NJVL-të që të publikojnë ose t'u dorëzojnë autoriteteve kompetente raporte të rregullta, vetëm **shtatë NJVL** publikojnë **raporte për mbikëqyrje inspektuese** në veprimtaritë komunale, për planifikim dhe ndërtimin hapësinor dhe urbanistik, në faqen e tyre të internetit.

Gjithsej **12 NJVL** konfirmuan se qytetarët i informojnë edhe përmes gazetës së tyre mujore ose **informatorit**, i cili është në dispozicion në formë elektronike ose në letër. Praktikë e mirë është edhe publikimi i një liste të **pyetjeve të parashtruara shpesh dhe të përgjigjeve** në një vend të dukshëm në faqen e internetit, gjë që e kanë miratuar vetëm **pesë NJVL**.

Gjithashtu nuk vërehet shumë angazhimi i NJVL-së ndaj qytetarëve të kategorive të ndryshme sociale, gjë që duket nga mungesa e informatave për **personin përgjegjës për kontakt me personat me aftësi të kufizuara**, e cila figuron vetëm në **19 NJVL**, ashtu siç vetëm **19 NJVL** kanë publikuar informacione për **kushtet dhe kriteret për shfrytëzimin e shërbimeve sociale dhe marrjen e ndihmës financiare**. Një numër shumë i vogël i NJVL-ve publikojnë informacion për numrin e përfituesve të ndihmës sociale sipas kategorive, gjë që mund të jetë e dobishme edhe për NJVL-të gjatë planifikimit të buxhetit.

Përmes faqes së internetit të saj ose përmes mjeteve të tjera digjitale të jashtme, vetëm **17 NJVL** ofrojnë **shërbime elektronike** për qytetarët. Pavarësisht nëse shërbimet ofrohen nëpërmjet faqes së internetit të NJVL-së apo nëpërmjet mekanizmave të tjerë elektronikë, është e nevojshme që të gjitha informacionet për shërbimet elektronike të jenë të disponueshme në një format të unifikuar dhe në një vend në faqen e internetit të NJVL-së. Kështu, **51 NJVL** publikojnë **listën e shërbimeve që i ofrojnë** qoftë në mënyrë fizike apo elektronike, **14 NJVL** publikojnë **çmimoren e tarifave për lëshimin e akteve** dhe **35 NJVL** i publikojnë **formularët për qasje në të gjitha shërbimet**, ndërsa **29 NJVL** i publikojnë **formularët për qasje në disa nga shërbimet që i ofrojnë**.

1.4.2. Konsultimet publike

Baza e demokracisë lokale bazohet në konsultimet me qytetarët, si pushtet që është më i afërt me ta. Nëpërmjet konsultimeve publike mundësohet përfshirja e qytetarëve në identifikimin e prioriteteve të NJVL-ve, si dhe vlerësimi i efektit të politikave publike. Është detyrim ligjor i NJVL-ve të zbatojnë procesin e konsultimit nëpërmjet iniciativave qytetare, sondazheve, tubimeve të qytetarëve dhe referendumit, dhe njëkohësisht, t'u mundësojnë qytetarëve të dorëzojnë parashtrës dhe propozime për punën e organeve të NJVL-së dhe të administratës lokale.

Hulumtimet e sektorit të shoqërisë civile për përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje në nivel lokal tregojnë se një përqindje alarmante prej 82.21% e qytetarëve kanë deklaruar se nuk janë përfshirë fare në procese të tilla.²¹, gjë që tregon për një mungesë të theksuar në krijimin e politikave dhe shërbimeve në përputhje me nevojat e komunitetit. Në këtë drejtim, hulumtimi ynë tregoi se asnjë NJVL nuk i planifikon konsultimet publike përmes një **plani të strukturuar për konsultime publike** për fusha të ndryshme. Ekzistenca e një plani të tillë do të kontribuonte për një parashikueshmëri më të madhe në hartimin e politikave, gjë që do t'u ndihmonte qytetarëve në mënyrë plotësuese për t'u përfshirë në kohë në marrjen e vendimeve në nivel lokal. Në vitin e kaluar, gjithsej **13 NJVL** kanë organizuar të paktën **një forum të bashkësisës ose forum buxhetor**, ndërsa **15 NJVL** kanë organizuar **të paktën dy** forume të tilla.

Për vetëm **15 NJVL** mund të thuhet se ato e paraqesin shumicën e informacionit që lidhet me **debatet publike për vitin aktual**, me **thirrje për debatet publike** për vitin e fundit në dispozicion në **36 NJVL**, dhe **raportet e debateve publike** në dispozicion në **dy NJVL me shpjegime me shkrim dhe përgjigje ndaj komenteve dhe sugjerimeve** dhe **tre NJVL** me raporte të shkurtra pa detaje.

Gjithsej **35 NJVL** raportuan se **kanë mbajtur konsultime publike për propozimin e fundit të buxhetit**, ndërsa **thirrjen për pjesëmarrje në konsultime publike për buxhetin** e publikuan vetëm **31 NJVL** në faqen e tyre të internetit. **Raportet mbi konsultimet publike për propozim-buxhetin e fundit** janë të disponueshme vetëm në faqet e internetit të **11 NJVL-ve**, dhe karakteristikë e tyre është se të gjitha janë të ndryshme për nga forma e paraqitjes së informacionit.

1.4.3. Ndërveprimi me qytetarët

Zbatimi i politikave lokale duhet të udhëhiqet nga nevojat e qytetarëve. Prandaj, qytetarët duhet të përfshihen në vendimmarrje, përveç mjeteve ligjore për konsultim, edhe përmes mekanizmave të tjerë ekzistues të bashkëpunimit që ndihmojnë në kuptimin dhe plotësimin e nevojave të tyre.

Qytetarët e **27 NJVL-ve** mund ta kontaktojnë NJVL-në e tyre nëpërmjet një **byroje apo zyre speciale për kontakt me qytetarët**, ndërsa kryetarët/et e komunave të **34 NJVL-ve** kanë caktuar dhe publikuar **orë për konsultime me qytetarët**. Përveç kësaj, në faqet e tyre të internetit të vetëm **29 NJVL-ve** është theksuar publikisht **orari i punës me palët**.

Përveç kanaleve zyrtare, në mënyrë elektronike përmes faqes së internetit dhe fizikisht, praktikë e mirë është përdorimi i mediave sociale për komunikim të dyanshëm me qytetarët. Gjithsej **73 NJVL** komunikojnë me qytetarët përmes Facebook-ut, prej të cilëve **57 NJVL e përditësojnë rregullisht informacionin** përmes kësaj media sociale, ndërsa **16 NJVL** e bëjnë këtë **në mënyrë të parregullt**. Përveç Facebook-ut, media tjetër sociale përdorin **37 NJVL**, nga të cilat **19 NJVL** i

²¹ Hulumtim mbi mekanizmat e pjesëmarrjes qytetare. Fondacioni për Zhvillimin e Komuniteti Lokal, Shtip. Gjetet në: <https://tinyurl.com/2xs3pm52>

publikojnë rregullisht informatat, ndërsa 18 NJVL nuk janë aq të rregullta në publikimin e informacionit nëpërmjet këtij kanali të komunikimit.

Krahasuar me vitin 2022 kur madje **71 NJVL** raportuan se **në vitin e kaluar, nuk kanë vepruar në lidhje me propozimet e pranuar përmes ndonjë mjeti për pjesëmarrjen e qytetarëve**, këtë vit ky numër është reduktuar në **63 NJVL** që sërisht është një e dhënë alarmante që mund të jetë edhe tregues i arsyes së uljes së besimit të qytetarëve në vetëqeverisjen lokale.

Parashtresat dhe ankesat qytetarët e **66 NJVL-ve** mund t'i dorëzojnë në mënyrë elektronike përmes **kanalit të drejtpërdrejtë për komunikim online**, i cili është i disponueshëm në faqet zyrtare të internetit të NJVL-ve në disa forma, duke përfshirë një formular kontakti të drejtpërdrejtë, ose një formular ose mjet të specializuar për raportimin e problemeve. **Udhëzime të qarta dhe të plota për dorëzimin e parashtresave dhe ankesave** janë në dispozicion publik për qytetarët e **27 NJVL-ve** përmes faqeve të tyre të internetit.

Ka edhe disa mjete shitesë që disa prej NJVL-ve i përdorin për komunikim të dyanshëm me qytetarët në lidhje me parashtrimin e ankesave dhe raportimin e problemeve, ndër të cilat është edhe mjeti digjital **“mZaednica” (mKomuniteti)**, i cili është në dispozicion në nëntë komuna duke përfshirë Karposhin, Aerodromin, Kriva Pallankën, Makedonska Kamenicën, Koçanin, Shtipin, Vallandovën, Manastirin dhe Gostivarin.

1.5 INTEGRITETI

Integriteti dhe politikat e integritetit janë bazë për ndërtimin e besimit të autoritetet lokale dhe ushtrimin efektiv të të drejtave qytetare. Ato duhet të promovohen në nivel politik dhe administrativ për të siguruar sjellje etike, rezistencë ndaj korrupsionit dhe zhvillim të papenguar shoqëror. Integriteti i nëpunësve dhe funksionarëve është kryesor për parandalimin e konfliktit të interesave dhe funksionimin e mirë të vetëqeverisjes lokale.

Krahas transparencës, këtë vit NJVL-të shënuan progresin më të madh në fushën e **integritetit (35%)**, gjegjësisht një rritje prej 12% krahasuar me vitin 2022.

NJVL-TË ME INTEGRITETIN MË TË LARTË SIPAS INDEKSIT TË HAPJES NË VITIN 2024



Infografiku 8. NJVL-të me integritetin më të lartë sipas Indeksit të Hapjes në vitin 2024

Komunat me përqindjen më të lartë të përmbushjes së treguesve në këtë fushë janë komunat e **Demir Hisarit** dhe **Manastirit** me **80%**. Megjithatë, madje **15 NJVL** nuk publikojnë asnjë informacion që identifikohet me këtë fushë, duke përfshirë Haraçinën, Bogovinën, Dollnenin, Jegunovcën, Çuçer Sandevën, Çairin, Studeniçanin, Sopishten, Krivogashtanin, Rosomanin, Mogillën, Petrovecin, Radovishin, Rankovcën dhe Zelenikovën, të cilat automatikisht kanë përmbushje 0% të kriterëve. Ky numër është për gjashtë NJVL më i vogël se numri i NJVL-ve që nuk kanë publikuar asnjë informacion për këtë fushë në vitin 2022.

Kjo fushë fokusohet në nënfushën:

- 'Politikat e Integritetit dhe Konfliktit të Interesave' të cilat i referohen ekzistencës dhe disponueshmërisë së mekanizmave dhe politikave për integritet dhe politikave kundër korrupsionit, edukimit të punonjësve të administratës për këtë temë, kodit të etikës së nëpunësve administrativë dhe funksionarëve lokalë dhe parandalimit të konfliktit të interesave.

1.5.1. Politikat për integritet dhe konflikt të interesit

Se mungon një përkushtim i përcaktuar dhe i shprehur për ndërtimin e integritetit në vetëqeverisjen lokale, dëshmon edhe fakti se **47 NJVL** kanë publikuar **plan për integritet ose ndonjë politikë apo praktikë tjetër të brendshme kundër korrupsionit**, e cila përfshin masa për parandalimin dhe eliminimin e formave të ndryshme të sjelljeve korruptive dhe joetike në institucion. Një pjesë e madhe e NJVL-ve me mbështetjen e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit kanë miratuar politikë për integritet,²² megjithatë jo të gjitha janë të

²² Sistemi i integritetit në NJVL. Politikat e integritetit në NJVL. Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit. Gjetet në: <https://tinyurl.com/yeyr93xa>

disponueshme në ueb-faqet e tyre. Gjithashtu, vetëm **42 NJVL** kanë publikuar **kod të etikës për funksionarët lokalë dhe nëpunësit administrativë**.

Qytetarët e vetëm **11 NJVL-ve** kanë mundësinë të mësojnë se me cilin person zyrtar duhet të kontaktojnë përmes faqes së internetit të NJVL-së për **parregullsi në punën financiare të komunës**, ndërsa në faqet e internetit të vetëm **29 NJVL-ve** ka informacion për **personin përgjegjës për raportimin e brendshëm të mbrojtur**. I vogël është edhe numri i NJVL-ve që investojnë në **ngritjen e kapaciteteve** të punonjësve të tyre për tema që kanë të bëjnë me konfliktin e interesave, parandalimin e korrupsionit, apo raportimin në rast të parregullsive, gjegjësisht vetëm **18 NJVL** kanë një praktikë të këtillë.

Për të shmangur rrezikun e korrupsionit, vetëqeverisja lokale duhet të jetë plotësisht transparente dhe të publikojë rregullisht informacion mbi sponsorizimet dhe donacionet nga dhe për NJVL-të. Konstatimet tregojnë se vetëm **30 NJVL** kanë publikuar informacione në faqet e tyre të internetit rreth **sponsorizimeve dhe donacioneve** nga ana e tyre, ose donacioneve dhe sponsorizimeve që i kanë marrë si NJVL.

Gjithashtu vërehet nevoja për të forcuar integritetin dhe transparencën e NJVL-ve në procesin e punësimit. **Konkurs për punësimin e punonjësve të rinj** shpallin **22 NJVL**, ndërsa **vendimet për punonjësit e rinj** i publikojnë **12 NJVL** gjatë 12 muajve të fundit. Gjatë hulumtimit nuk u konstatua publikimi i listave të renditjes me pikë për vlerësimin e kandidatëve për punësim, në bazë të të cilave do të merrej një vendim i paanshëm.

1.6 TË DHËNAT E HAPURA


Të dhënat e hapura janë kryesore për qeverisjen e mirë në nivel lokal, sepse promovojnë transparencën, llogaridhënien dhe përfshirjen e qytetarëve. Duke ofruar qasje të lirë në të dhënat e hapura cilësore, autoritetet lokale mund të ofrojnë një pasqyrë më të qartë të punës së tyre, e cila më tej u mundëson qytetarëve ta monitorojnë punën e tyre, t'i kuptojnë vendimet dhe të marrin pjesë në mënyrë më aktive në proceset lokale. Nxitja e një kulture të të dhënave të hapura jo vetëm që ndihmon në ndërtimin e besimit midis funksionarëve dhe komunitetit, por gjithashtu inkurajon vendimmarrjen e bazuar në informata dhe inovacionin, gjë që çon në qeverisje më produktive dhe zhvillim ekonomik.

Sipas Ligjit për shfrytëzimin e të dhënave nga sektori publik²³, NJVL-të janë të detyruara të publikojnë vazhdimisht të dhëna të hapura, mirëpo është e qartë se institucionet në nivel kombëtar dhe lokal nuk janë mjaftueshëm të përkushtuara ndaj këtij detyrimi.

Përmes fushës horizontale të **të dhënave të hapura**, Indeksi i analizon praktikën e NJVL-ve për hapjen e të dhënave që i publikojnë, gjegjësisht shprehinë e NJVL-ve për publikimin e informatave në format të hapur që mund të përpunohen lehtësisht nga pikëpamja teknike. Hulumtimi i këtij viti tregoi se NJVL-të përmbushin **17%** të treguesve që përfshihen në fushën e të dhënave të


²³ Ligjit për shfrytëzimin e të dhënave nga sektori publik. Gjendet në: <https://tinyurl.com/mryp48j>

hapura, e cila, gjë që krahasuar me situatën e disa viteve më parë, tregon një përparim të ngadaltë.



Infografiku 9. Historiku i publikimit të të dhënave të hapura nga NJVL-të sipas Indeksit të Hapjes

Megjithëse këto rezultate janë të dobëta, ka disa shembuj të mirë të NJVL-ve që janë angazhuar në mënyrë aktive në përgatitjen dhe publikimin e të dhënave të hapura. Në këtë fushë, **rezultatet më të mira i kanë Demir Hisari (37%) dhe Prilepi (35%)**, ndërsa **renditje më të ulët kanë Llozova (3%) dhe Sopishteja (2%)**.




Infografiku 10. NJVL-të më të përkushtuara në publikimin e të dhënave të hapura



Infografiku 11. NJVL-të me përkushtimin më të ulët për publikimin e të dhënave të hapura

Portali kombëtar për të dhënat e hapura deri më sot përmban **656 grupe të dhënash** të publikuara nga **74 subjekte**. Ndër ato subjekte janë **19 NJVL**, nga të cilat **14 NJVL kanë publikuar grupe të dhënash në format të hapur**. Pas një shqyrtimi më të hollësishëm, mund të vërehet se vetëm një pjesë e këtyre grupeve të të dhënave të publikuara nga NJVL-të janë të dy viteve të fundit, që do të thotë se **publikimi i të dhënave të hapura nuk është një praktikë e vazhdueshme e vetëqeverisjes lokale**. Marrë në përgjithësi, megjithëse ka përmirësim në publikimin e të dhënave të hapura te një pjesë e NJVL-ve, ka nevojë për më shumë përpjekje në përgatitjen, publikimin dhe përditësimin e grupeve të të dhënave në format të hapur (të lexueshëm nga makina), si në portal ashtu edhe në faqet e tyre zyrtare të internetit.

2. PLANI GJITHËPËRFSHIRËS PËR QEVERISJE TË MIRË NË INSTITUCIONET E PUSHTETIT LOKAL NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT



2. Plani gjithëpërfshirës për qeverisje të mirë në institucionet e pushtetit lokal në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Për të përmirësuar hapjen e NJVL-ve, në vijim propozojmë një plan gjithëpërfshirës me rekomandime që duhet të shërbejnë si udhërrëfyes për qeverisjen e mirë në nivel lokal.

TRANSPARENCA

- Është e nevojshme të përgatitet një dokument i vetëm ose akt nënligjor që do të zbatohet për të gjitha NJVL-të dhe që do t'i përmbajë të gjitha informatat që NJVL-të duhet t'i publikojnë në faqet e tyre të internetit dhe si ta praktikojnë hapjen ndaj publikut. Në këtë mënyrë do të sigurohet barazi, parashikueshmëri dhe krahasueshmëri të informatave që do të publikohen.
- Rekomandohet unifikimi i faqeve të internetit të të gjitha NJVL-ve, në kuptimin që të dhënat e publikuara në faqen e internetit të jenë të strukturuar mirë dhe të publikuara brenda menyve dhe seksioneve të faqeve të internetit në mënyrë që të gjenden lehtësisht.
- Faqja zyrtare e internetit duhet të jetë mjeti bazë i NJVL-së për informimin e publikut për punën e organeve të komunës, për shërbimet që i ofron, duke i përfshirë edhe ato shërbime që i ofron nëpërmjet shërbimeve publike, si dhe për informatat dhe të dhënat e tjera që rrjedhin nga kompetencat e NJVL-së.
- Faqet e internetit të NJVL-ve duhet të zhvillohen në përputhje me rekomandimet dhe standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, duke përfshirë edhe standardet që e lehtësojnë qasjen për personat me aftësi të kufizuara, të jenë funksionale dhe të përditësohen rregullisht në të gjitha gjuhët që janë në përdorim zyrtar në NJVL, e sipas mundësisë edhe në anglisht.
- Faqja e internetit duhet të përditësohet pas çdo ndryshimi të bërë në një dokument apo akt, dhe pas çdo ngjarjeje, takimi apo të ngjashme, si dhe dy herë në vit duke i kontrolluar të gjitha informacionet e publikuara. Andaj, lind nevoja për procedura të brendshme që duhet të përgatiten nga NJVL-të për veprim, me qëllim të publikimit në kohë të të gjitha informatave që lidhen me ushtrimin e kompetencave të tyre.
- Faqet e internetit të NJVL-ve duhet t'i plotësojnë kërkesat e sigurisë kibernetike dhe të kenë të vendosur Politikë të privatësisë.
- Me qëllim të disponueshmërisë dhe qasshmërisë më të madhe, përveç buletineve zyrtare, të gjitha të dhënat dhe informacionet e prodhuara nga NJVL-të duhet të jenë të strukturuar mirë dhe të publikohen drejtpërdrejt brenda menyve dhe seksioneve të ueb-faqeve të NJVL-ve.
- Rekomandohet pilotimi i krijimit të një njësie organizative në NJVL-të më të mëdha, e cila do të jetë drejtpërdrejt përgjegjëse për sigurimin e kushteve për menaxhim të hapur, nëpërmjet transparencës dhe qasjes në informatat me karakter publik.

- Është e nevojshme të publikohen sa më shumë të dhëna në format të hapur, e për këtë gjë duhet që në momentin e krijimit dhe sistematizimit të tyre të futen në format që do të mundësojë publikimin dhe përdorimin e tyre të lehtë (të paktën paraqitje tabelore).
- NJVL-të duhet t'i publikojnë grupet e të dhënave (të dhënat e hapura) që i krijojnë në faqet e tyre të internetit, si dhe në Portalin nacional të të dhënave të hapura. Gjithashtu, NJVL-të duhet të caktojnë një Zyrtar për të dhënat e hapura.
- NJVL-të duhet të ofrojnë trajnime të vazhdueshme për personat përgjegjës për transparencë dhe llogaridhënie, për të ngritur nivelin e të kuptuarit të çështjes, si dhe për shkak të veprimit të tyre të drejtë dhe ligjor.
- Për të garantuar transparencë aktive, NJVL-të në faqet e tyre të internetit duhet t'i publikojnë rregullisht informatat e mëposhtme:
 - informacion mbi organizimin e NJVL-së, gjegjësisht organogramin, kompetencat e NJVL-së, statutin e NJVL-së, listën e ligjeve që kanë të bëjnë me kompetencat e NJVL-së, biografinë e kryetarit/es të/së komunës, listat e plota të pozicioneve dhe kontaktet e të gjithë punonjësve, zyrtarëve me informacionet e kontaktit (emri dhe mbiemri, pozita, njësia/sektori, numri i zyrës, telefoni zyrtar dhe e-maili), informata për këshilltarët dhe komisionet e Këshillit dhe organet e tjera punuese;
 - rrogat dhe link deri te fletët e anketimit të zyrtarëve të zgjedhur dhe të emëruar, si dhe kompensimet për këshilltarët dhe rregulloren për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit dhe mëditjeve për udhëtimet zyrtare për këshilltarët dhe nëpunësit shtetërorë;
 - rregulloren e punës së këshillit komunal, rendin e ditës së seancave, si dhe procesverbalet dhe informacione të tjera lidhur me punën e Këshillit;
 - vendimet e marra nga ana e kryetarit/es të/së komunës dhe këshillat e NJVL-ve;
 - regjistrimet me video ose zë (audio) të seancave të Këshillit, si dhe transmetimi i drejtpërdrejtë i tyre;
 - njoftimet për punën e Këshillit dhe kryetarit/es të/së komunës përmes publikimit në kohë të komunikatave;
 - informacione për punësimet e përkohshme, si dhe personat e angazhuar me kontratë në vepër ose kontratë autoriale;
 - shërbimet e ofruara nga NJVL-ja;
 - informacione për ndërmarrjet publike dhe institucionet që janë themeluar nga NJVL-ja (pjesa e pronësisë së NJVL-së në ndërmarrjet publike, statuti, këshilli drejtues dhe mbikëqyrës, llogaria vjetore, gjegjësisht përfundimtare, aktet për përdorimin e të ardhurave të realizuara dhe përcaktimin e çmimeve për shërbimet);
 - propozim-buxhetin së bashku me buxhetin qytetar, me qëllim të kuptimit më të lehtë nga qytetarët;
 - buxhetin, menjëherë pas miratimit të tij, së bashku me planet vjetore financiare dhe programet për realizimin e buxhetit;
 - raportet tremujore dhe vjetore për realizimin e buxhetit nga viti paraprak, llogaritë përfundimtare dhe informacione për borxhet;
 - të gjitha dokumentet për furnizimet publike (planet, thirrjet, vendimet, kontratat dhe anekset, raportet vjetore) ose të paktën një link deri te Portali i Vetëm

Elektronik për Furnizimet publike për të gjitha prokurimet publike të NJVL-së konkrete me shpjegim të detajuar;

- informacion mbi procedurat për tenderët publikë, koncesionet apo partneritetet publiko-private;
- të dhënat për financimin e projekteve apo shërbimeve nga organizatat e shoqërisë civile, për financimin e fondacioneve dhe klubeve sportive (thirrjet dhe vendimet për fondet e alokuara);
- raportet nga Enti Shtetëror i Revizionit që kanë të bëjnë me vetëqeverisjen lokale;
- të dhënat për bashkësitë lokale dhe urbane së bashku me emrat dhe kontaktet e kryetarëve të tyre.

VETËDIJËSIMI

- Vizioni dhe misioni për zhvillimin e NJVL-së duhet të theksohen publikisht në një vend të veçantë në faqen e internetit të NJVL-së;
- Është e nevojshme të krijohen dhe të publikohen dokumentet strategjike dhe programore të NJVL-së që përmbajnë qëllime dhe rezultate të përcaktuara qartë, me implikime buxhetore dhe tregues për matjen e rezultateve (strategjitë sektoriale komunale, strategjitë për zhvillim ose planet zhvillimore me plan veprim);
- Programet vjetore për punë të NJVL-ve dhe këshillave komunale me aktivitete konkrete, afatet kohore dhe implikimet buxhetore duhet të vendosen publikisht në faqet e internetit të NJVL-ve;
- Është e nevojshme që rregullisht të krijohen dhe të publikohen raportet vjetore për punën e kryetarit/es së/të komunës, Këshillit të komunës dhe ndërmarrjeve publike komunale, gjë që do të ofrojë një pasqyrë të asaj që është realizuar në raport me aktivitetet e planifikuara, me sa mjete dhe në cilat afate, që të mund të matet performanca;
- Rekomandohet të publikohet programi vjetor për investime për ndërmarrjen publike komunale në faqen e internetit të NJVL-së dhe nëse është e mundur (nëse ekziston), në faqen e internetit të ndërmarrjes publike komunale;
- Rekomandohet përdorimi i treguesve të suksesit gjatë zhvillimit të programeve dhe raporteve vjetore që do të mundësojnë matjen e suksesit të programeve dhe zbulimin e sfidave të mundshme.

QASSHMËRIA

- Të dhënat e personit zyrtar për qasje të lirë në informatat me karakter publik (emri dhe mbiemri, e-maili dhe telefoni), formularët për parashtrimin e kërkesës, lista e informatave me karakter publik të komunës (gjithçka që është publikuar në faqen e internetit, sipas kategorive dhe mundësisht në formë të linkut deri te informata përkatëse), përgjigjet e anonimizuara për kërkesat për qasje të lirë, dhe materialet informative për ushtrimin e së drejtës për qasje në informatat me karakter publik, duhet të publikohen në një vend të dukshëm ose të shënjohen me një baner të veçantë;


- Të dhënat për personin përgjegjës për mbështetjen e personave me aftësi të kufizuar në komunikim me administratën lokale duhet të vendosen publikisht në faqen e internetit të NJVL-së;
 - Çdo NJVL duhet të publikojë një katalog të shërbimeve të ofruara nga NJVL-ja me të dhënat e kontaktit të njësive organizative kompetente dhe të zyrtarëve përgjegjës;
 - Është e nevojshme të sigurohet qasje e dukshme në shërbimet elektronike ose formularët për qasje në shërbime, me shpjegim të saktë të mënyrës së ofrimit të shërbimit, si dhe një çmimore të tarifave për lëshimin e akteve;
 - Rekomandohet vendosja publike e të dhënave për kushtet dhe kriteret për shfrytëzimin e shërbimeve sociale dhe marrjen e ndihmës financiare në ueb-faqen e NJVL-së;
 - Është e nevojshme që të gjitha NJVL-të të angazhohen për publikimin e rregullt të propozim-planeve urbanistike dhe planeve të miratuara urbanistike;
 - Rekomandohet krijimi, publikimi dhe përditësimi i listave, regjistrave ose kadastrave të detajuara të:
 - veprimtarive të hotelierisë dhe veprimtarive turistike me vëllim të vogël,
 - objekteve të kategorizuara të hotelierisë,
 - evidencës së hotelierëve,
 - personave fizikë që ushtrojnë veprimtari turistike, guidave turistike dhe shoqëruesve,
 - shërbimeve në turizmin rural, etnik ose ekologjik,
 - kadastrës së mjedisit jetësor,
 - lejeve të dhëna të integruara ekologjike -B,
 - ndotësve, krijuesve të zhurmës dhe krijuesve të mbeturinave,
 - licencave për mbeturina,
 - qendrave për grumbullimin e mbeturinave elektrike dhe elektronike,
 - licencave për largimin e automjeteve të dëmtuara dhe atyre me defekt nga rrugët lokale,
 - transportuesve dhe automjeteve për transportin e udhëtarëve dhe mallrave,
 - lejeve të lëshuara për vendosjen e objekteve të përkohshme dhe pajisjeve urbane,
 - kërkesave të parashtruara për përcaktimin e statusit juridik të objekteve të paligjshme,
 - tregjeve, deponive, parkingjeve dhe zonave industriale,
 - çerdheve të fëmijëve, shkollave fillore dhe të mesme,
 - shtëpive për të moshuarit dhe institucioneve mbrojtëse,
 - objekteve sportive dhe klubeve sportive,
 - menaxherëve të ndërtesave,
 - organizatave të shoqërisë civile në territorin e NJVL-së,
 - institucioneve komunale në fushën e kulturës,
 - monumenteve dhe memorialeve përkujtimore,
 - emrave dhe numrave të ndërtesave, shesheve, urave dhe objekteve të tjera të infrastrukturës,
- nëse është e zbatueshme për territorin të cilin e mbulon NJVL-ja;
- Është e nevojshme të publikohen raporte vjetore për lejet e lëshuara të ndërtimit, raportet për mbikëqyrjen e kryer inspektuese;

- Është e nevojshme të përcaktohet qartë mënyra e komunikimit të NJVL-së, kryetarit/es të/së komunës dhe anëtarëve të Këshillit me qytetarët dhe të ruhet komunikimi i rregullt i dyanshëm (ditë të hapura, zyra për kontakt me qytetarët, me e-mail, në telefon, nëpërmjet një mjeti elektronik të faqes së internetit, mediave sociale, informatorit);
- Rekomandohet aktivizimi i një kanali të drejtpërdrejtë online ose mjeti elektronik për raportimin e problemeve me mundësinë e komunikimit të dyanshëm, si dhe udhëzime të qarta për dorëzimin e parashtresave dhe ankesave;
- NJVL-të duhet t'i trajtojnë më shpesh propozimet e marra nga qytetarët nëpërmjet mjeteve për pjesëmarrjen e qytetarëve;
- Rekomandohet publikimi i një kalendari vjetor për konsultimet e planifikuara, si dhe publikimi i rregullt i thirrjeve për pjesëmarrje në konsultime dhe debate publike, dhe i raporteve të detajuara pas konsultimeve të bëra me komente dhe përgjigje;
- Është e rëndësishme që të gjitha NJVL-të të angazhohen për organizime më të shpeshta dhe gjithëpërfshirëse të forumeve të bashkësisës, si dhe të forumeve buxhetore.

INTEGRITETI

- Rekomandohet publikimi i një dokumenti programor që do t'i identifikojë rreziqet e korrupsionit dhe konfliktit të interesave dhe do të propozojë masa dhe aktivitete konkrete për reduktimin e tyre;
- Rekomandohet publikimi i një akti për kufizimin e marrjes së dhuratave nga kryetari/ja i/e komunës, anëtarët e Këshillit dhe administrata lokale (shuma dhe posedimi, sipas ligjit);
- Të gjitha NJVL-të duhet ta publikojnë Kodin Etik për funksionarët lokalë dhe nëpunësit administrativë;
- Rekomandohet publikimi i informacionit të kontaktit për personin e autorizuar për raportimin e brendshëm të mbrojtur, si dhe për personin e autorizuar për parregullsi;
- Rekomandohet publikimi i informacionit për sponsorizimet dhe donacionet për NJVL-të dhe nga NJVL-të;
- Regjistri i dhuratave të marra duhet të vendoset publikisht në faqet e internetit e të gjitha NJVL-ve;
- Rekomandohet krijimi, përditësimi dhe publikimi i evidencës së rasteve të raportuara të konfliktit të interesit nga ana e anëtarëve të Këshillit ose kryetari/ja i/e komunës, si dhe i pasurisë së tundshme dhe të patundshme të NJVL-së;
- Rekomandohet publikimi i procedurës për përdorimin e automjeteve zyrtare, si dhe i procedurës për raportimin dhe miratimin e mungesës zyrtare dhe private nga vendi i punës.
- Është e rëndësishme të futet një praktikë e rregullt e publikimit të informacionit për konkurset për punësim, kandidatët e paraqitur, përzgjedhjen e kryer dhe vendimin për punësimin e kandidatit me listë renditjeje me pikë për secilin kandidat që ka aplikuar për pozitën;
- Rekomandohet ngritja e kapaciteteve të administratës lokale për konfliktin e interesave, parandalimin e korrupsionit dhe raportimin në rast të parregullsive.

SHTOJCA 1. STRUKTURA E INDEKSIT TË HAPJES NË NIVEL LOKAL



Shtojca 1. Struktura e Indeksit të Hapjes në nivel lokal

Fusha: Transparenca	
Nënfusha: Angazhimi për transparencë dhe llogaridhënie	
1	A përditësohet rregullisht faqja e internetit?
2	A publikohen informacionet në mënyrë të barabartë në të gjitha gjuhët zyrtare?
3	A është funksional mjeti i kërkimit në ballinën e faqes së internetit?
4	A ka komuna ndonjë dokument (strategji, politikë, procedurë) në lidhje me hapjen dhe transparencën?
5	A kanë ndjekur vitin e fundit punonjësit në komunë trajnim apo ndonjë lloj tjetër edukimi për qasje në informatat me karakter publik?
6	A kanë marrë pjesë vitin e fundit punonjësit e komunës në ndonjë trajnim/punëtori për nëpunësit administrativë për konceptin e të dhënave të hapura dhe a kanë marrë udhëzime se si të përdoren dhe të publikohen të dhënat në format të hapur?
7	A ka emëruar komuna zyrtarë për të dhënat e hapura?
8	A publikon komuna grupe të dhënash të hapura në data.gov.mk?
Nënfusha: Informacione për organizatën	
9	A është publikuar organigrami i komunës në faqen e internetit?
10	A janë publikuar kompetencat e komunës në faqen e internetit?
11	A është publikuar biografia e kryetarit/es të/së komunës në faqen e internetit të komunës?
12	A është publikuar statuti i komunës në faqen e internetit?
13	A është publikuar Rregullorja e punës së Këshillit të komunës në faqen e internetit të komunës?
14	A janë publikuar informacionet për emrat, pozicionet dhe kontaktet e nëpunësve administrativë në faqen e internetit të komunës?
15	A janë publikuar në faqen e internetit informacionet për personat e angazhuar me kontrata në vepër, kontrata për punë të përkohshme dhe kontrata autoriale?
16	A janë publikuar në faqen e internetit informacionet për anëtarët e Këshillit me emrin, fotografinë dhe detajet e kontaktit?
17	A është publikuar lista e ligjeve që kanë të bëjnë me kompetencat e komunës?
18	A janë publikuar në faqen e internetit informacionet për pjesëmarrjen e komunës në ndërmarrjet publike?
19	A janë publikuar në faqen e internetit emrat dhe kontaktet e kryetarëve të bashkësive lokale/urbane?
20	A janë publikuar në faqen e internetit informacionet në lidhje me komisionet dhe organet e punës së Këshillit?
21	A është publikuar statuti i ndërmarrjes publike komunale?

22	A janë publikuar informacionet për anëtarët e këshillit drejtues dhe mbikëqyrës të ndërmarrjes publike komunale?
Nënfusha: Marrja e vendimeve	
23	A janë publikuar në faqen e internetit rendet e ditës së seancave të Këshillit?
24	A janë publikuar në faqen e internetit procesverbalet e seancave të Këshillit?
25	A publikohen në faqen e internetit vendimet e miratuara nga Këshilli?
26	A janë të disponueshme drejtpërdrejt me zë ose video seancat e Këshillit?
27	A janë publikuar në faqen e internetit incizimet me zë/video të seancave të Këshillit në vitin e fundit?
28	A është publikuar në faqen e internetit të paktën një komunikatë/deklaratë për shtyp nga një seancë e Këshillit në tre muajt e fundit?
29	A publikohen rregullisht komunikata për takimet e realizuara zyrtare me informacione të detajuara nga takimi?
Nënfusha: Transparenca financiare	
30	A është publikuar në faqen e internetit buxheti i komunës për vitin aktual?
31	A ka publikuar komuna buxhet qytetar për vitin aktual?
32	A i është dorëzuar Këshillit vendimi për buxhetin para datës 1 dhjetor të vitit aktual?
33	A publikohen raportet tremujore për realizimin e buxhetit?
34	A është publikuar llogaria përfundimtare në faqen e internetit?
35	A publikohen informacione për borxhet e komunës?
36	A janë publikuar në faqen e internetit planet për prokurime publike?
37	A janë publikuar në faqen e internetit thirrjet për prokurime publike?
38	A janë publikuar në faqen e internetit vendimet për prokurime publike?
39	A janë publikuar në faqen e internetit kontratat për prokurime publike?
40	A publikohen në faqen e internetit anekset e kontratave për prokurime publike?
41	A janë publikuar në faqen e internetit planet vjetore financiare dhe programet për realizimin e buxhetit?
42	A janë publikuar në faqen e internetit raportet e Entit Shtetëror të Revizionit?
43	A është publikuar në faqen e internetit informacioni për rrogat e funksionarëve?
44	A është publikuar në faqen e internetit të komunës të paktën një informacion për koncesionet, PPP-të apo tenderët publikë në vitin e fundit?
45	A janë publikuar në faqen e internetit raportet për realizimin e planit për prokurime publike?
46	A ka publikuar komuna të paktën një thirrje për projekte për organizatat e shoqërisë civile gjatë vitit të kaluar?
47	A janë publikuar në faqen e internetit vendimet për fondet e alokuara për organizatat e shoqërisë civile?

48	A është publikuar llogaria vjetore e ndërmarrjes publike komunale?
49	A është publikuar akti me të cilin përcaktohen çmimet për shërbimet e ndërmarrjes publike komunale?
50	A është publikuar akti për shfrytëzimin e të ardhurave të realizuara të ndërmarrjes publike komunale?
51	A është publikuar llogaria përfundimtare e ndërmarrjes publike komunale?
52	A është i disponueshëm për qytetarët informacioni për kompensimet e anëtarëve të Këshillit të komunës?
53	A është e disponueshme për qytetarët Rregullorja për pagesën e shpenzimeve dhe mëditjeve për udhëtimet zyrtare brenda dhe jashtë vendit për anëtarët e këshillit dhe nëpunësit shtetërorë?
Fusha: Vetëdijësimi	
Nënfusha: Planifikimi dhe programimi	
54	A është publikuar në faqen e internetit programi vjetor i komunës për vitin aktual?
55	A është publikuar në faqen e internetit programi vjetor i Këshillit të komunës për vitin aktual?
56	A janë publikuar në faqen e internetit strategjitë sektoriale komunale (të cilat vlejné edhe për vitin aktual)?
57	A ka komuna një dokument të shkruar gjithëpërfshirës ku i vendos qëllimet e saj (Strategji për Zhvillim apo Plan Zhvillimor) që vlen edhe për vitin aktual?
58	A ka publikuar komuna plan veprim për realizimin e Strategjisë për Zhvillim?
59	A është publikuar programi vjetor i investimeve për vitin aktual të ndërmarrjes publike komunale?
60	A përdor ndërmarrja publike komunale tregues të suksesit gjatë zhvillimit të programit vjetor?
61	A përdor komuna tregues të suksesit gjatë zhvillimit të programit vjetor?
Nënfusha: Monitorimi dhe vlerësimi	
62	A është publikuar në faqen e internetit raporti i punës së kryetarit/es së/të komunës për vitin e kaluar?
63	A është publikuar në faqen e internetit raporti i punës së Këshillit për vitin e kaluar?
64	A është publikuar në faqen e internetit raporti i punës së ndërmarrjes publike komunale për vitin e kaluar?
65	A përdor komuna tregues të suksesit kur i përgatit raportet vjetore për punën e vitit të kaluar?
Fusha: Qasshmëria	
Nënfusha: Qasja në informata dhe shërbime	
66	A i publikon komuna propozim-planet e detajuara urbanistike në territorin e komunës?
67	A i publikon komuna planet e miratuara të detajuara urbanistike në territorin e komunës?
68	A ka publikuar komuna regjistër të organizatave të shoqërisë civile?

69	A ka publikuar komuna listën e veprimtarive të hotelerisë me vëllim të vogël?
70	A ka publikuar komuna listën e veprimtarive turistike me vëllim të vogël?
71	A ka publikuar komuna listën e shërbimeve në turizmin rural, etnik dhe ekologjik?
72	A ka publikuar komuna të dhëna për zonat industriale në territorin e komunës?
73	A ka publikuar komuna Kadastër të mjedisit jetësor?
74	A ka publikuar komuna Regjistër të lejeve të dhëna të integruara ekologjike -B?
75	A ka publikuar komuna Regjistër të ndotësve?
76	A ka publikuar komuna Kadastër të krijuesve të zhurmës?
77	A ka publikuar komuna Kadastër të krijuesve të mbeturinave?
78	A ka publikuar komuna të dhëna për transportuesit dhe mjetet motorike për transportin e udhëtarëve dhe mallrave në komunikacionin rrugor?
79	A ka publikuar komuna të dhëna për tregjet në territorin e komunës?
80	A ka publikuar komuna të dhëna për deponitë në territorin e komunës?
81	A ka publikuar komuna të dhëna për parkingjet në territorin e komunës?
82	A ka publikuar komuna regjistër të çerdheve për fëmijë në komunë?
83	A ka publikuar komuna regjistër të shkollave fillore në komunë?
84	A publikon komuna regjistër të shkollave të mesme në komunë?
85	A ka publikuar komuna të dhëna për shtëpitë e pleqve në territorin e komunës?
86	A janë publikuar në faqen e internetit raportet e inspektimit të kryer mbikëqyrës?
87	A janë publikuar në faqen e internetit informacionet për institucionet për mbrojtjen e kategorive të ndryshme të qytetarëve?
88	A janë publikuar në faqen e internetit informatat për numrin e shfrytëzuesve të ndihmës sociale (sipas kategorive)?
89	A është publikuar në faqen e internetit Regjistri i mbeturinave (licencat e lëshuara)?
90	A janë publikuar në faqen e internetit qendrat e grumbullimit të mbeturinave elektrike dhe elektronike?
91	A janë publikuar licencat e lëshuara për largimin e automjeteve të dëmtuara dhe me defekt nga rrugët komunale dhe lokale?
92	A është publikuar raporti vjetor për lejet e lëshuara për ndërtim?
93	A është publikuar Regjistri i lejeve të lëshuara për vendosjen e objekteve të përkohshme dhe pajisjeve urbane?
94	A është publikuar Regjistri i kërkesave të parashtruara për përcaktimin e statusit juridik të objekteve të paligjshme?
95	A është publikuar Regjistri i emrave të rrugëve dhe numrave të ndërtesave, shesheve, urave dhe objekteve të tjera të infrastrukturës?
96	A është publikuar Regjistri i menaxhuesve të ndërtesave të banimit?

97	A janë publikuar informacione për objektet sportive në territorin e komunës?
98	A janë publikuar informacione për klubet sportive?
99	A është publikuar Regjistri i monumenteve dhe memorialeve përkujtimore?
100	A janë publikuar informacione për institucionet komunale në fushën e kulturës?
101	A është publikuar Regjistri i personave fizikë që kryejnë veprimtari turistike, guidave turistike dhe shoqëruesve?
102	A është publikuar Regjistri i objekteve të hotelerisë sipas kategorisë?
103	A është publikuar evidenca e hotelierëve?
104	A janë publikuar informatat e kontaktit për personin përgjegjës për qasje të lirë në informatat me karakter publik?
105	A janë publikuar përgjigjet e anonimizuara për pyetjet për të cilat është miratuar qasje në informatat me karakter publik?
106	A është publikuar procedura (metoda) për marrjen e informatave me karakter publik?
107	A ka faqja e internetit meny (seksion) të veçantë për të drejtën e qasjes së lirë në informatat me karakter publik?
108	A ka komuna gazetën (ose buletinin) e saj mujor/e (elektronike apo në letër)?
109	A janë publikuar në faqen e internetit përgjigjet për pyetjet e parashtruara shpesh?
110	A është publikuar në faqen e internetit Lista e informatave me karakter publik?
111	A ofrohen shërbime elektronike në faqen e internetit?
112	A është publikuar në faqen e internetit lista e shërbimeve të ofruara nga komuna (në mënyrë fizike dhe elektronike)?
113	A janë publikuar në faqen e internetit formularët për qasje në shërbime?
114	A është publikuar lista e tarifës për lëshimin e akteve të komunës?
115	A janë publikuar në faqen e internetit informacione për kushtet dhe kriteret për shfrytëzimin e shërbimeve sociale dhe marrjen e ndihmës financiare?
116	A është publikuar emri dhe detajet e kontaktit të personit përgjegjës për kontakt me personat me aftësi të kufizuara?
Nënfusha: Konsultimet publike	
117	A u publikua është publikuar thirrja për pjesëmarrje në konsultime publike për buxhetin?
118	A është publikuar në faqen e internetit raport për konsultimet publike të mbajtura për propozim-buxhetin e fundit?
119	A janë të disponueshme në ueb-faqe planet për konsultime publike të komunës për vitin aktual?
120	A janë publikuar në faqen e internetit thirrjet për debate publike?
121	A mund të gjenden në faqen e internetit informacionet e nevojshme për debatet publike të vitit aktual?
122	A ka mbajtur komuna konsultime publike për propozim-buxhetin e fundit?

123	A janë publikuar në faqen e internetit raportet e detajuara nga debatet publike (me shpjegime me shkrim dhe përgjigje për komentet dhe sugjerimet)?
124	A organizon komuna forum të bashkësisës (ose forum buxhetor, si një formë e forumit të bashkësisë)?
Nënfusha: Ndërveprimi me qytetarët	
125	A ka byro/zyre për kontakt me qytetarët?
126	A ka caktuar kryetari/ja i/e komunës orë pranimi për konsultime me qytetarët?
127	A ka komuna profil aktiv në Facebook?
128	A ka komuna profil aktiv në një rrjet tjetër social?
129	A janë publikuar në faqen e internetit udhëzimet për dorëzimin e parashtresave dhe ankesave?
130	A ka një kanal të drejtpërdrejtë komunikimi online në faqen e internetit përmes të cilit qytetarët do të mund të dorëzojnë parashtresa dhe ankesa?
131	A është publikuar orari i punës me palë?
132	A ka vepruar komuna në vitin e fundit në lidhje me ndonjë propozim të pranuar përmes ndonjë mjeti për pjesëmarrje qytetare (iniciativë qytetare, tubim qytetar, referendum, parashtresa dhe propozime)?
Fusha: Integriteti	
Nënfusha: Politikat për integritet dhe konfliktin të interesit	
133	A është publikuar plani për integritet apo ndonjë praktikë tjetër e brendshme kundër korrupsionit (që përfshin masa për parandalimin dhe eliminimin e formave të ndryshme të sjelljes korruptive dhe joetike në institucion)?
134	A është publikuar në faqen e internetit Kodi Etik për funksionarët lokalë dhe nëpunësit administrativë?
135	A është publikuar në faqen e internetit emri dhe kontakti i personit përgjegjës për raportimin e brendshëm të mbrojtur?
136	A është publikuar në faqen e internetit emri dhe detajet e kontaktit të personit përgjegjës për parregullsi?
137	A publikohen në faqen e internetit informacione për sponsorizimet dhe donacionet nga ana e komunës?
138	A publikohen shpalljet për punësim dhe personat e sapo punësuar me pikët e fituara në procedurë gjatë 12 muajve të fundit?
139	A kanë ndjekur gjatë vitit të kaluar punonjësit në administratën komunale ndonjë trajnim/punëtori apo aktivitete të tjera edukative për tema si konflikti i interesave, parandalimi i korrupsionit, raportimi në rast të parregullsi?

Fondacioni për Internet dhe Shoqëri - “Metamorfozis” është fondacion i pavarur, jopartiak dhe jofitimprurës me seli në Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut.

Misioni i tij është të kontribuojë në zhvillimin e demokracisë dhe në rritjen e cilësisë së jetës përmes përdorimit novator dhe shpërndarjes së njohurive. Vlerat tona kryesore janë transparenca, barazia dhe liria.

Fushat programore në të cilat punon “Metamorfozis” janë:

- Mediat për demokraci
- Edukimi për inovacione
- Përgjegjësia shoqërore
- Të drejtat e njeriut në internet

